




MenCare



Gjendja e Baballarëve të Botës, Ballkan



PERKRAHUR NGA:



WITH FUNDING FROM
 AUSTRIAN
DEVELOPMENT
COOPERATION

 Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

 OAK
FOUNDATION

Ky publikim u realizua me mbështetjen e Agjensionit Austriak për Zhvillim, Ambasadës së Suedisë në Bosnjë e Hercegovinë dhe Fondacionit OAK. Përmbajtja e këtij publikimi nuk paraqet qëndrimet e Qeverisë Austriake, Qeverisë Suedeze apo të Fondacionit OAK.

Gjendja e Baballarëve të Botës, Ballkan



MenCare

Gjendja e Baballarëve të Botës, Ballkan

CARE International në Ballkan, si pjesë të strategjisë për barazi gjinore dhe fuqizimin e grave, ka edhe angazhimin e djemve dhe burrave për të adresuar dhunën në bazë gjinore dhe pabarazitë gjinore që i bëjnë dëm grave dhe vajzave (si dhe burrave e djemve). Që nga viti 2006, CARE punon për të sfiduar normat dominuese shoqërore që i kontribuojnë dhunës dhe kufizojnë qasjen e plotë të grave e vajzave në të drejtat e tyre njerëzore. Në punën tonë me burra të rinj, ne kemi kërkuar të promovojmë koncepte më pozitive dhe më të shëndosha të maskulinitetit dhe të angazhojmë burrat e rinj si aleatë për të arritur barazinë gjinore.

Duke punuar për të adresuar norma më të gjera shoqërore dhe drejtësi gjinore në komunitete në rajonet e Ballkanit, ne besojmë që më shumë duhet të bëhet për të promovuar ndryshime në raportet dhe përgjegjësitë familjare që fillojnë para se fëmijët të shkojnë në shkollë. Përmes punës sonë me fushatën MenCare (shqip. Kujdesi i Burrave), ne kërkuam që të promovojmë përfshirjen e burrave si baballarë dhe përkujdesës të barabartë dhe jo të dhunshëm për të arritur mirëqenie familjare, barazi gjinore, dhe shëndet më të mirë për nënat, baballarët, dhe fëmijët. Ne synojmë që burrat të jenë aleatë në përkrahjen e barazisë shoqërore dhe ekonomike për gratë duke marrë më shumë përgjegjësi në përkujdesjen e fëmijëve

dhe në punë të shtëpisë. Ne besojmë që barazia e vërtet do të arrihet vetëm kur burrat të jenë 50% në kujdesin e fëmijëve dhe në punë të shtëpisë në mbarë botën. Një raporti i tillë, në fakt i pari për Gjendjen e Baballarëve që është lansuar në qershor të vitit 2015 në 10 qytete rreth botës, ofron një fotografi periodike me të dhëna për gjendjen e kontributit të burrave në prindërim dhe përkujdesje në nivel global duke adresuar katër çështje: përkujdesjen pa pagesë në shtëpi; të drejtat dhe shëndetin seksual e riprodhues, si dhe shëndetin amënor, të të porsalindurve dhe të fëmijëve; përkujdesjen e burrave dhe dhunën ndaj grave dhe fëmijëve; si dhe zhvillimin e fëmijëve.

Përfshirja pozitive e burrave në jetën e partnereve dhe fëmijëve të tyre krijon mundësi globale për barazi, dhe kjo përfshirje sjell dobi për gratë, fëmijët, dhe për vet burrat. Angazhimi i burrave si baballarë të përfshirë mund të ndikoj në shëndet të përmirësuar amënor dhe të fëmijëve, raporte më të forta dhe më të barabarta ndërmjet partnerëve, në ulje të nivelit të dhunës ndaj grave dhe fëmijëve, si dhe ka dobi të përhershme për vajzat dhe djemtë e këtyre baballarëve. Hulumtimi ka treguar që përfshirja e burrave si përkujdesës po ashtu rezulton në dobi për vet ata: i bën baballarë më të mirë, i përmirëson raportet e tyre intime, dhe e rrit cilësinë e jetës.

Ky raport është hartuar për të theksuar të gjeturat dhe rekomandimet nga Raporti Global dhe për të theksuar të dhënat dhe politikat ekzistuese nga Evropa jug-lindore/Ballkani (Shqipëri, Kroacia, Serbia, Bosnja dhe Hercegovina, dhe Kosova). Si pjesë e procesit kemi realizuar një shqyrtim të politikave nga rajoni, nga fokus grupet me baballarë dhe politikë-bërësit e angazhuar, hulumtuesit dhe profesionistët e OJQ-ve për të zhvilluar rekomandimet për politikat kyçe si pjesë e konferencës së parë rajonale rreth atësisë dhe përkujdesjes të organizuar më 11-13 nëntor 2015 në Sarajevë. Si rezultat i kësaj konference, shumë qeveritarë politikë-bërës të angazhuar për barazi gjinore janë përkushtuar për të përfshirë disa nga rekomandimet për atësi dhe përkujdesje me norma të drejta gjinore në strategjitë ekzistuese apo në zhvillimin e strategjive të reja. Objektivat e qëndrueshme zhvillimore (ang. SDG) ofrojnë një nivel të përkrahjes dhe llogaridhënies për politikë-bërësit të bëhen bashkë me hulumtuesit dhe aktivistët për drejtësi gjinore për ta adresuar barazinë gjinore, dhunën ndaj grave dhe fëmijëve përmes zhvillimit të politikave që theksojnë të drejtat e njeriut dhe mirëqenien e familjeve.

Shpresojmë që ky raport ofron përkrahje për hulumtuesit, politikë-bërësit dhe OJQ-të që bëhen bashkë për t'i përmirësuar politikat dhe për të zhvilluar veprime kon-

krete nga të cilat përfitojnë gratë, burrat, fëmijët dhe të gjitha familjet në rajon. Ne mezi presim të punojmë me ju në hapat e ardhshëm për të adresuar atësinë dhe përkujdesjen dhe sa i kontribuojnë këto të fundit barazisë gjinore.

Falenderimet tona më të përzemërta i shkojnë Asociacionit të prindërve për promovimin dhe mbështetjen e “Folesë” së prindësisë së përgjegjshme nga Beogradi, i cili përmes konsulentve të tij Aleksandra Galonja dhe Tanja Azanjac Janjatovic dha kontributin e çmuar në zhvillimin e këtij raporti, falenderime shkojnë njashtu për z. Elvis Kralj, aktivist nga Cakovec, i cili ndau me ne përvojën e tij si prind. Ne do donim të shprehnim mirënjohjen tonë edhe për Promundo, Rutgers, Save the Children, Sonke Gender Justice dhe Aleancën MenEngage për përmbledhjen e Gjendjes së Botës së Baballarëve, përmbjeldhje kjo e përfshirë në këtë dokument.

CARE International Balkans



Babai më i
MIRË



Gjendja e atësisë në Ballkan

Hyrje >

Përprojekjet e vazhdueshme për të kuptuar rolin e burrave në arritjen e barazisë gjinore dhe për t'i shërbyer të drejtave dhe mirëqenies së fëmijëve, dhe posaçërisht çështjes që në mënyrë të drejtpërdrejtë ndikon tek shëndeti i fëmijës, arrijtjet arsimore, socializimi, dhe në mirëqenien e përgjithshme të fëmijës; si dhe perspektivën e burrave për rolet gjinore dhe të drejtat e grave në përgjithësi; shpjen tek iniciativat të cilat përplojnë të promovojnë përmirësimin e rolit pozitiv të burrave në jetën e fëmijëve dhe roleve e përgjegjësisë të balancuara në punët e shtëpisë.

Projekti i CARE “Djemtë dhe Burrat si Aleatë në Parandalimin e Dhunës dhe Normat e Dëmshme Gjinore në Ballkanin Perëndimor” apo Iniciativa e Burrave të Rinj (ang. YMI), është një iniciativë e tillë. E zbatuar në Kroaci, Shqipëri, Bosnje e Hercegovinë, Kosovë e Serbi, projekti shënjestron burrat e rinj për zbrëthimin e sfidave që ata i hasin, veçanërisht rreth normave të caktuara shoqërore dhe kulturore rreth maskulinitetit. Adresimi i normave gjinore, edhe në aspektin e promovimit të barazisë gjinore si dhe adresimin e disa sjelljeve me rrezikshmëri me të cilat përballen burrat e rinj rreth shëndetit dhe dhunës, kërkon angazhimin e djemve dhe burrave të rinj (burrat në mbarë shoqërinë) për t'i adresuar qëndrimet, pikëpamjet dhe veprimet që ndikojnë në zgjedhjet e djemve dhe burrave (si dhe vajzave dhe grave).

Për të vënë një bazë në përprojekjet rajonale për promovimin e barazisë gjinore duke e njohur rëndësinë e angazhimit aktiv të burrave në promovimin dhe arritjen e kësaj barazie, ky punim përmban një rishikim të politikave dhe praktikave rajonale që e pranojnë ndërrimin aktual në kontekstualizimit të çështjeve gjinore si çështje ekskluzive të grave. Si një ndër shembujt më të mirë në këtë ndërrim është atësia e përgjegjshme, dhe njohja e atësisë së përgjegjshme në praktikatat politike rajonale. Kjo do të shërbente si udhërrëfyes për promovim të gjerë të barazisë gjinore si përgjegjësi e tërë shoqërisë, dhe jo vetëm si ‘shqetësim i grave’.


Edhe pse për disa lëvizje, çështja e atësisë dhe përkujdesjes mund të jetë çështje kontroverze; ndonëse feminizmi dhe atësia mund të shkojnë bashkë edhe në aspektin politik e edhe në atë teorik: “Ndryshimin më revolucionar që mund ta bëjmë në institucionin e amësisë është të përfshijmë burrat në secilin aspekt të kujdesit ndaj fëmijëve¹. Prandaj, pavarësisht ndryshimeve evidente pozitive në realitetin shoqëror për gratë, burrat ende në mënyrë dominuese, perceptohen si kryefamiljarë dhe gratë si përkujdesëse. Kjo dinamikë rezulton në shpërndarje të barabartë të punës së papaguar dhe si rezultat, në pabarazi ekonomike dhe pabarazi të përgjithshme.

Përveç dobive të dukshme për barazinë gjinore, pjesëmarrja më e madhe e burrave në kujdesin

1 - Ruddick, S. (1995). Të menduarit amënor: Drejt një politike të pjesës. Boston: Beacon Press.

e fëmijëve dhe në zhvillim, ka dëshmuar të ketë rëndësi të madhe për mirëqenien e fëmijëve në përgjithësi: Është me rëndësi të theksojmë që standardet e Konventës për të Drejtat e

Fëmijëve² kanë parë që ndërlikimet e tyre praktike kanë dëshmuar në disa hulumtime dhe studime që përfshirja e baballarëve ka ndikim të drejtpërdrejtë në mirëqenien e fëmijëve³:



Duke e pasur parasysh që barazia dhe drejtësia gjinore si dhe promovimi i të drejtave të fëmijëve përbëjnë shqetësim

të përbashkët, me këtë punim duam të parashtojmë disa pyetje të cilave mund t'i përgjigjemi së bashku në të ardhmen.

2 - E përshtatur dhe hapur për nënshkrim, ratifikim dhe pranim nga rezoluta 44/25 e Asamblesë së Përgjithshme të 20 nëntorit 1989; ka hyrë në fuqi më 2 shtator 1990.

3 - Ball, J., Mossele, K. (2007). Kontributi i Baballarëve për Mirëqenien e Fëmijëve. Agjencia e Shëndetit Publik të Kanadasë.

Gjendja e atësisë në Ballkan

Shqyrtim i metodologjisë >

Parimet Udhëzuese

Si anëtare e fushatës MenCare⁴ Care International Balkans që nga viti 2006 "ka punuar dhe i ka angazhuar djemtë dhe burrat e rinj për sfidimin e normave të dëmshme gjinore dhe promovimin e maskuliniteteve të shëndosha. Si rezultat i këtij programi, CARE ka kuptuar se ka nevojë të punoj me burrat e rinj që do të bëhen baballarë së shpejti dhe me ata që sapo janë bërë prindër. Që nga viti 2012, CARE bën hulumtime për të kuptuar më mirë rolin e baballarëve në kontekstin rajonal të vendeve të Ballkanit. Hulumtimi ka ndihmuar për të vënë bazat e programit të cilin e ka zhvilluar."⁵ Ky shqyrtim është një hap shtesë në këtë drejtim. Duke qenë partner në këtë fushatë, Care International Balkans dhe partnerët e saj besojnë dhe pajtohen për parimet vijuese:

1. Barazia gjinore në prindërim sjellë dobi për burrat dhe për mirëqenien e tyre;
2. Promovimi i të drejtave të grave;
3. Promovimi i të drejtave të fëmijëve;
4. Promovimi i shëndetit dhe të drejtave seksuale dhe riprodhuese;
5. Besojnë që transformimi i atësisë do të

- ul dhunën në bazë gjinore;
6. Kërkojnë transformimin e praktikave prindërore për t'i dhënë fund dhunës ndaj fëmijëve;
7. Përkrahin prindërit jo-biologjik dhe njohin diversitetin në prindërim;
8. Përkrahin të drejtën e të gjithë njerëzve për tu kujdesur për fëmijët, përfshirë komunitetet LGBT dhe grupet e tjera të marginalizuara;
9. Promovojnë praninë e baballarëve gjatë shtatzënisë dhe lindjes;
10. Avokojnë për pushim të paguar prindëror për të dy prindërit.⁶

Të përfshira në të gjitha programet dhe veprimet e Care International Balkans, këto parime po ashtu kanë ofruar strukturën për këtë shqyrtim drafti.

Subjekti dhe Qëllimet

Subjekt i këtij shqyrtimi janë politikat dhe praktikatat në promovimin e praktikave të shëndosha, të barabarta dhe jo të dhunshme prindërore dhe tipare specifike të barazisë gjinore, dhe si rrjedhojë atësia dhe përkujdesja atërore, si dhe ndarja e punëve në shtëpi, në Kroaci, Serbi, Bosnje dhe Hercegovinë, Kosovë dhe Shqipëri.

4 · <http://men-care.org/>

5 · <http://men-care.org/about-mencare/our-partners/>

6 · <http://men-care.org/about-mencare/guiding-principles/>

Përfshirja e babait (atësi aktive) përkufizohet si pjesëmarrje pozitive, e gjerë dhe aktive e burrave në jetën e fëmijëve të tyre⁷. Roli aktiv i babait mund të përkufizohet edhe në shumë mënyra të tjera:

- bashkëveprim i drejtpërdrejtë në mes të babait dhe fëmijës (përmes lojës, përkujdesjes);
- disponueshmëria, apo sa i pranishëm është babai për fëmijën e tij kur nevojitet;
- ndërtimi i kapitalit shoqëror, apo si baballarët ofrojnë rrjet mbështetës për fëmijët që kur të rriten të kontribuojnë në shoqëri.⁸

Për më shumë, përveç relevancës së lartë për të drejtat e fëmijëve, kujdesi atëror është çështja më e rëndësishme e drejtësisë gjinore, që i cilëson burrat si agentë ndryshimi për barazi gjinore.

Në këtë mënyrë, ky shqyrtim fokusohet në çështjet relevante për barazi gjinore, sikurse në struktura për promovimin e tij, pushimin e paguar prindëror, ndarjen e punëve në shtëpi, etj.

Qëllimet specifike të këtij shqyrtimi janë:

a) Të njoh mundësitë dhe pengesat rajonale normative dhe rregulluese; b) Të siguroj kuptim më të qartë për praktikatat rajonale më relevante; dhe c) Të fitoj njohuri nga shembujt specifikë për atësinë aktive në Serbi.

Metodologjia

Çështja e atësisë, si një nga aspektet e normave shoqërore dhe të sjelljes që lidhen

me rolet gjinore, dhe në të njëjtën kohë – fenomen të cilit nuk i është dhënë vëmendje e nevojitur në praktikatat rajonale teorike dhe politike, ka kërkuar përdorimin e metodologjisë kualitative. Për t'i kuptuar parakushtet e promovimit të praktikave të shëndosha, të barabarta dhe jo të dhunshme prindërore, si strategji për avancimin e barazisë gjinore dhe mirëqenies së fëmijës, janë përdorur informacione të ndryshme dhe teknika të mbledhjes së të dhënave:

- Analizë e të dhënave dytësore – politikat dhe instrumente ndërkombëtare, raportet nga organet e shtetit, dokumente legjislative rajonale dhe politikat publike për barazi gjinore në përgjithësi dhe atësi, si aspekti kryesor specifik;
- Diskutime në fokus grupe me baballarë aktivë e të angazhuar.

Analizimi i të dhënave dytësore ka përfshirë analizimin e **standardeve ndërkombëtare** që i përkasin barazisë gjinore dhe të drejtave të fëmijëve në përgjithësi, por edhe të rolit të burrave në arritjen e barazisë gjinore dhe të drejtave të fëmijëve në veçanti.

Përmbledhje e kornizës legjislative kombëtare

në vendet ku projekti zbatohet është ofruar duke identifikuar kornizat e përgjithshme kundër-diskriminuese dhe të barazisë gjinore. Në këtë mënyrë, aktet më të përgjithshme janë analizuar për të përcaktuar vlerat e sistemit për atësinë dhe parakushtet për promovimit e tij. Për më shumë, ligjet që janë posaçërisht relevante për atësinë aktive (Ligji i Punës, Ligjet Gjinore, etj.) janë analizuar dhe prezantuar.

7 · Marsiglio, W., Day, R.D., Lamb, M.E. (2000). "Shqyrtim i diversitetit në atësi: Ndërlikimet në konceptualizimin e përfshirjes së baballarëve". *Shqyrtim i Martesës dhe Familjes*, 29, 269–293.

8 · Pleck, J.H., & Masciadrelli, B.P. (2004). "Përfshirja prindërore nga baballarët në SHBA: Nivelet, burimet dhe pasojat". Nw M.E.Lamb (Ed.), *Roli i Babait në Zhvillimin e Fëmijës, Edicioni i 4të* (faqet 222-271). Hoboken, NJ: Wiley.

Babai më i
MIRË



Në këtë segment të hulumtimit, vëmendje e plotë i është kushtuar **materialeve** të mbledhura nga organizatat e përfshira në projektin Djemtë dhe Burrat si Aleatë ne Parandalimin e Dhunës dhe Sfidimin e Normave të Dëmshme Gjimore në Ballkanin Perëndimor, e publikuar në formë të raporteve vjetore dhe shumë-vjetore, studime, broshura, dhe të ngjashme. Po ashtu, përmbledhja nën lentën gjimore është përdorur për të shikuar në mënyrë specifike se ku politikat dhe praktikatat do të mund të promovonin ndërmarrjen e praktikave të drejta dhe jo të dhunshme për atësinë.

Për të kuptuar perceptimin e burrave për kujdesin atëror, një fokus grup nga diskutimi është organizuar me baballarë aktiv e të angazhuar nga Serbia.

Qëllimi ishte të eksploroj perceptimin e tyre për kujdesin atëror dhe rolin e babait në jetën e fëmijës nga pikëvështrimi i kontekstit posaçërisht të veçantë socio-kulturor në shoqërinë serbe.

Objektivat ishin si në vijim:

- a. të eksploroj pikëpamjet e të anketuarve për atësinë/kujdesin atëror;
- b. të eksploroj natyrën dhe cilësinë e raportit të partneriteteve të tyre nga perceptimi i roleve të ndryshme të baballarëve për dallim të roleve që nënat kanë në aspekte të ndryshme të përkujdesjes (me fjalë të tjera, në kujdesin shëndetësor, në arritjet arsimore, në socializim përfshirë rolet gjimore, etj.), dhe në punë të shtëpisë;
- c. të diskutoj dallimet në mes të baballarëve aktivë dhe të angazhuar dhe modeleve të tjerë në rrethinën e tyre, si dhe të krahasoj qasjen e tyre drejt kujdesit atëror me qasjen e prindërve të tyre;

d. të diskutoj masat mbështetëse ekzistuese për kujdesin atëror të zhvilluar në politika dhe praktika – njohjen e dinamikave ekzistuese, problemet kryesore dhe rekomandimet për punë të më tutjeshme;

Duke pasur në konsideratë natyrën specifike të subjektit, është zbatuar metodologjia gjysmë projektuese në kombinim me pyetësin – që ka synuar të vërejturit e përgjithshëm të ndarjes së punëve të shtëpisë dhe kujdesit ndaj fëmijëve ndërmjet partnerëve, që shërben si nxitje për diskutim.

Duke qenë të vetëdijshëm për të pasur vetëm një fokus grup, është vendosur të ekzaminohet subjekti nga perspektiva e minoritetit të baballarëve aktivë e të angazhuar për të kuptuar qartë dinamikat kryesore në shoqëri të parë përmes “syve të tyre”. Prandaj, në aspektin e mostrës dhe procesit të rekrutimit, shtatë burra (të grupmoshës 30 dhe 45), që prindërimin e renditin lartë si prioritet dhe në mënyrë aktive marrin pjesë në bazë ditore në përkujdesje, morën pjesë në fokus grup. Rekrutimi është realizuar përmes asociacioneve prindërore aktive në Serbi.

Babai më i
MIRË



I WILL NEVER
GROW
UP



Babai më i
MIRË

Gjendja E atësisë

Standardet Ndërkombëtare për Promovimin e Atësisë Aktive >

Baza për promovimin e atësisë pozitive mund të gjendet në dokumentet kryesore që rregullojnë të drejtat e grave dhe fëmijëve. Përkatësisht, Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave,⁹ dhe tu garantoj atyre "të njëjtat të drejta dhe përgjegjësi si prindër, pavarësisht statusit të tyre martesor, për çështje që lidhen me fëmijët e tyre"; si dhe "të njëjtat të drejta për të vendosur lirshëm dhe përgjegjshëm për numrin dhe hapësirat në mes të lindjes së fëmijëve të tyre, dhe të kenë qasje në informacion, arsimim dhe mjete që u mundësojnë atyre t'i ushtrojnë këto të drejta"; "të njëjtat të drejta dhe përgjegjësi në lidhje me kujdestarinë, përgjegjësinë, ruajtjen dhe birësimin e fëmijëve, apo institucione të ngjashme ku këto koncepte ekzistojnë në legjislacionin kombëtar "¹⁰.

Në mënyrë të ngjashme, Konventa për të Drejtat e Fëmijëve¹¹ njeh detyrimet e shtetit për "të siguruar që një fëmijë nuk do të ndahen nga prindërit e tij/saj kundër vullnetit të tij/saj përveç në rastet kur autoritetet kompetente i nënshtrohen vendimit si rrjedhojë e shqyrtimit gjyqësor, në përputhje me ligjet

dhe procedurat në zbatim, që një ndarje e tillë është e nevojshme për interesin më të mirë të fëmijës. Një përcaktim i tillë mund të jetë i nevojshëm në raste që përfshijnë abuzimin apo braktisjen e fëmijës nga prindërit, apo në rastet kur një prindërit jetojnë ndaras dhe një vendim duhet marrë për vendin e banimit të fëmijës; "respekt për të drejtën e fëmijës që është i ndarë nga njëri apo të dy prindërit për të mirëmbajtur lidhjet personale dhe kontaktin e drejtpërdrejtë me të dy prindërit në baza të rregullta, përveç nëse është në kundërshtim me interesat më të mira të fëmijës"¹². CRC përshkruan obligimet e shtetit për "të përdorur përpjekjet e tyre më të mira për rritjen dhe zhvillimin e fëmijës", si posaçërisht relevante për çështjen e atësisë. Prindërit apo, sido që të jetë rasti, kujdestarët ligjorë, kanë përgjegjësi parësore për rritjen dhe zhvillimin e fëmijës. Interesat më të mira për fëmijën do të jenë shqetësimi i tyre bazë"¹³.

Duke analizuar praktikat ndërkombëtare në promovimin e barazisë gjinore, ndryshim i paradigmit "gratë janë akterët kryesorë" në paradigmin e "përgjegjësinë së përbashkët"

9 · Përshtatur dhe hapur për nënshkrim, ratifikim dhe pranim nga rezoluta e Asemblesë së Përgjithshme 34/180 të 18 dhjetorit 1979; hyrja në fuqi më 3 shtator 1981.

10 · CEDAW. Neni 16, paragrafet 4., 5., dhe 6.

11 · Përshtatur dhe hapur për nënshkrim, ratifikim dhe pranim nga rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme 44/25 të 20 nëntorit 1989; hyrja në fuqi: 2 shtator 1990.

12 · CRC. Neni 9, paragrafet 1. dhe 3.

13 · CRC. Neni 18, paragrafi 1.

për të arritur barazi, ka qenë pika kthyesë e prezantimit të masave specifike për promovimin e atësisë. Në atë mënyrë, Deklarata e Pekinit dhe Platforma për Veprim¹⁴ i ka inkurajuar burrat të marrin pjesë plotësisht në të gjitha veprimet për barazi gjinore, dhe kanë bërë thirrje për themelimin e parimeve të pushtetit dhe përgjegjësisë së përbashkët ndërmjet grave dhe burrave në shtëpi, në komunitet, në vendin e punës dhe në komunitete më të gjëra kombëtare dhe ndërkombëtare.

Korniza më relevante për promovimin e kujdesit atëror dhe përfshirjes më të madhe të burrave në përkujdesje mund të gjendet në përfundimet e sesionit të 48të i Komisionit për Statusin e Grave¹⁵. Përfundimet janë formuluar në lidhje me:

- Njohjen e rëndësisë së kontributit të djemve dhe burrave për barazi gjinore (përfshirë kontributin e tyre në familje);
- Promovimin e njohjes së rëndësisë së baballarëve (bashkë me nënat, kujdestarët ligjorë, dhe përkujdesës të tjerë) për mirëqenie të fëmijëve dhe promovimit të barazisë gjinore;
- Nevojën për zhvillimin e politikave, programeve dhe plan-programeve shkollorë që inkurajojnë përfshirjen e tyre pozitive në arritjen e barazisë gjinore dhe rezultateve të mira për fëmijët, familjet dhe komunitetet;
- Nevojën për të krijuar dhe përmirësuar programet trajnuese dhe edukative për të ngritur vetëdijen dhe njohurinë e burrave (dhe grave) për rolet e tyre si prindër, kujdestarë ligjorë dhe përkujdesës, dhe

për rëndësinë e ndarjes së përgjegjësisë familjare, dhe duke i përfshirë baballarët (po ashtu) në programe ku mësohet për zhvillimin e kujdesit të fëmijëve;

- Zhvillimin dhe përfshirjen e informacionit në mënyra dhe mjete për të rritur kapacitetin e burrave për të rritur fëmijë në mënyrë të orientuar kah barazia gjinore në programe edukative për prindërit, kujdestarët ligjorë dhe përkujdesës të tjerë;
- Përshtatjen dhe zbatimin e legjislacionit dhe/apo politikave për të shuar dallimet në pagesë së burrave dhe grave dhe pajtimit rreth përgjegjësisë profesionale dhe familjare, përfshirë uljen e ndarjes profesionale, prezantimit të pushimit të zgjatur prindëror, aranzhime pune fleksibile, sikurse punë vullnetare me orar të shkurtuar, duke punuar nga shtëpia përmes teknologjisë, dhe punë të tjera që mund të bëhen nga shtëpi;
- Inkurajimin e burrave të marrin pjesë plotësisht në kujdesin dhe mbështetjen për të tjerët, përfshirë personat më të vjetër, personat me aftësi të kufizuara dhe personat e sëmurë; në veçanti fëmijët e të varurve të tjerë, përmes trajnimit dhe edukimit.

Rekomandime edhe më specifike janë formuluar në raport në diskutimin online të grupit të ekspertëve të Komisionit:

- Zgjerimi i pushimit të atësisë;
- Ofrimi i opsioneve për orar më fleksibil të punës, mundësi për burra për të punuar me orar të përgjysmuar kur bëjnë fëmijë;

14 · Raporti në Konferencën e Katërt Botërore për Gratë, Pekin 4-15 shtator 1995 (publikimet e Kombeve të Bashkuara, Sales No.E.96.IV.13).

15 · Sesioni 48, 1-12 mars 2004. *Roli i burrave dhe djemve në arritjen e barazisë gjinore*. Përfundimet e pajtuara, 12 mars 2004, sikurse janë adoptuar.

- Ndryshimi i ligjeve të familjes, përfshirë ligjet që kanë të bëjnë me kujdesin e fëmijëve për tu mundësuar burrave të jenë partner dhe përkujdesës më aktivë në jetën e fëmijëve dhe tjerëve që varen nga ta;
- Zgjerimi i dispozitave të kujdesit të fëmijëve, përfshirë sigurimin e qendrave ditore për kujdes ditor me numër të caktuar të punëtorëve, dhe konsiderimi i burrave si dhe i grave në kalkulimin e nevojave të fëmijëve;
- Zbatimi i programeve në sistemin e arsimit publik për t'i pajisur djemtë dhe burrat me shkathtësitë dhe njohuritë e nevojshme për të marr role të reja në shtëpi, përfshirë kurset e bazuara në shkollë për "shkathtësi jetese" për djemtë.

Përtej këtyre rekomandimeve, Departamenti për Punë Ekonomike dhe Shoqërore të Sekretariatit të Kombeve të Bashkuara, ka prezantuar rekomandimet shtesë në publikimin *Burrat në Familje*. Ato janë si në vijim¹⁶:

- Politika edukative të hartuara për të inkurajuar përfshirjen e burrave me fëmijët e tyre në shkollë dhe kujdes ditor, dhe për të inkurajuar më shumë burra për tu përfshirë në mësimdhënie dhe kujdesin e hershëm të fëmijërisë;
- Politika shëndetësore që inkurajojnë burrat të marrin pjesë në kujdesin amënor dhe të fëmijëve, përfshirë gjatë lindjes së fëmijës dhe në të gjitha çështjet që përfshijnë shëndetin riprodhues dhe seksual;
- Politika për zbutjen e varfërisë dhe kushteve bazike për jetesë që njohin rolet

e burrave dhe grave, njohin konfigurimet e ndryshme familjare, përfshirë nevojat dhe realitetet e grave dhe burrave që migrojnë dhe familjet me një prind vetushqyes, dhe që përkrahin edhe burrat e edhe gratë për të mbajtur nën kontroll të përbashkët asetet dhe vendimmarrjen familjare, dhe kushte jetese të mjaftueshme dhe me dinjitet.

Si agjenda më e rëndësishme politike, e adoptuar së voni nga Objektivat e Qëndrueshme Zhvillimore të Kombeve të Bashkuara (ang. SDGs)¹⁷, që synojnë t'i japin fund varfërisë, luftës kundër pabarazive dhe padrejtësive, dhe ta adresojnë ndryshimin klimatik deri në vitin 2030, ofrojnë një agjendë të gjerë qëndrueshmërie dhe adresojnë shkaqet rrënjësore të varfërisë dhe nevojës universale për zhvillim që funksionon për të gjithë njerëzit. Në këtë mënyrë, këto objektiva mund të konsiderohen si korniza më relevante politike për të gjitha veprimet e shteteve në të ardhmen, por edhe aktorëve të tjerë relevant si organizatat e shoqërisë civile dhe të tjerët. "Këto objektiva zhvillimore synohen të jenë universale në kuptimin e personifikimit të një vizioni global të përbashkët për progres për një hapësirë të sigurt, të drejtë dhe të qëndrueshme që të gjitha qeniet njerëzore të përparojnë në planet. Ato reflektojnë parimet morale që askush dhe asnjë vend nuk do të lihet pas, dhe që secili dhe secili vend do të trajtohet se mban përgjegjësi të përbashkët për ta bartur këtë vizion global. Në kushte të përgjithshme, të gjitha qëllimet janë konceptuar si ambicie dhe sfida për të gjitha vendet. Të gjitha qëllimet dhe targetet përmbajnë porosi dhe sfida të rëndësishme si

16 · Publikim i Kombeve të Bashkuara (2011). *BURRAT NË FAMILJE* dhe Politikat Familjare në një Botë që po Ndryshon: Kombet e Bashkuara.

17 · Të shtatëdhjetë Objektivat e Qëndrueshme Zhvillimore janë adoptuar në Asamblenë e 70të të Përgjithshme të BE-së me qëllimin për t'i dhënë fund të gjitha formave të varfërisë deri në vitin 2030.

për vendet në zhvillim, ashtu edhe për vendet e zhvilluara.”¹⁸

Përmes qëllimit të pestë të SDGve, *Arritja e barazisë gjinore dhe fuqizimi i grave dhe vajzave*, kjo rithemelon obligimin e shteteve për përmirësimin e politikave dhe praktikave për barazi gjinore. Targete specifike që lidhen me përfshirjen më të madhe të burrave për arritjen e barazisë gjinore përmes rritjes së përgjegjësisë në punë të shtëpisë dhe përkujdesje të fëmijëve janë targetet 5.4 (*Njohja dhe vlerësimi i punës së papaguar dhe punëve të shtëpisë përmes dispozitave të shërbimeve publike, infrastrukturës dhe politikave për mbrojtje sociale dhe promovimin e përgjegjësisë së përbashkët në punë të shtëpisë dhe në familje si e përshtatshme në nivel kombëtar*) dhe 5.6 (*Sigurimi i qasjes universale në shëndetin seksual e riprodhues dhe në të drejta riprodhuese në pajtim me Programin për Veprim të Konferencës Ndërkombëtare për Popullatën dhe Zhvillimin, dhe Platformën e Pekinit për Veprim dhe dokumentet dalëse për konferencat e tyre shqyrtuese*). Prioritetet brenda targetit 5.6 janë përshkruar përmes Neni 5, paragrafi 2 e CEDAË (*Palët shtetërore do t'i marrin të gjitha masat e duhura për të siguruar që edukata familjare përfshinë njohurinë për lehoninë si funksion shoqëror dhe njohjen e përgjegjësisë të përbashkëta për burrat dhe gratë në rritjen dhe zhvillimin e fëmijëve të tyre, që nënkuptohen që interesi i të gjithë fëmijëve është konsiderata fillestare në të gjitha rastet*).

Përveç rëndësisë që ka posedimi i funksionit të rëndësishëm në arritjen e barazisë gjinore

dhe mirëqenies së përgjithshme të fëmijës, atësia dhe përfshirja më e madhe e burrave në rritjen dhe zhvillimin e fëmijëve dhe punës së papaguar, sigurojnë që luajnë rol shumë të rëndësishëm në uljen e varfërisë dhe njihet si e tillë nga akterët dhe politikat më të rëndësishme ndërkombëtare, përfshirë SDG-të dhe Strategjinë Euro 2020¹⁹.

Politikat e barazisë gjinore të Bashkimit Evropian po ashtu njohin rëndësinë e përfshirjen dhe përgjegjësisë më të madhe të burrave për barazi gjinore. Disa nga studimet dhe dokumentet më relevante që kanë të bëjnë me këto çështje janë: Përfundimet e Këshillit të Bashkimit Evropian për Burrat dhe Barazinë Gjinore (2006)²⁰, Strategjia e Komisionit Evropian për Barazi në mes të Grave dhe Burrave 2010-2015²¹, studimi Roli i Burrave për Barazi Gjinore – strategjitë dhe pikëvështrimet evropiane, prodhuar nga Komisioni Evropian në 2012²².

Pasi që korniza e BE-së është posaçërisht relevante për këtë punim shqyrtues dhe për vendet ku zhvillohen projektet e CARE International, rekomandimet nga studimi mund të shërbejnë si pikënisje për të gjitha përpjekjet e së ardhmes për promovimin e kujdesit atëror. Rekomandime specifike që lidhen me këtë temë janë formuar në lidhje me:

- Mbështetjen për përfshirjen e burrave në përkujdesje të fëmijëve
- Themelimin e sistemeve për pushim prindëror më të balancuar në kontekstin gjinor si çështje kryesore
- Zhvillimin e masave stimuluese për

18 · Objektivat e Qëndrueshme Zhvillimore: T'i kuptojmë Sfidat Transformuese për Vendet në Zhvillim. Raport i një Studimi nga Stakeholder Forum. <http://www.stakeholderforum.org/index.php/news>.

19 · COM(2010) 2020 finale, Bruksel, 3.3.2010. EUROPE 2020, *Strategji për rritje të zgjuar, të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse*.

të shpërblyer prindërit e fëmijëve parashkollor për balancë gjinor në kujdesin pas periudhës së pushimit prindëror

- Bërjen e dobive të përfshirjes së burrave në përkujdesje të dukshme
- Themelimin e përkrahjes së balancit gjinor në përkujdesje tek çiftet dhe familjet si target parësor i reformimit të politikave
- Hulumtim për të kuptuar ndikimet (e paqëllimshme) të reformave në fusha të ndryshme të politikave për ndarjen e punës së paguar dhe të papaguar në familje
- Inkurajimin e përfshirjes së burrave në punë të shtëpisë përtej kujdesit ndaj fëmijëve
- Kundërshtimin e stereotipeve që punët e shtëpisë nuk përkojnë me figurën tradicionale të maskulinitetit, duke përdorur model autentik me balancë gjinor.

20 · 15487/06. Takimi 2767 i Këshillit , Bruksel, 30 Nëntor–1 Dhjetor 2006. *Përfundimet e Këshillit të Bashkimit Evropian për Burrat dhe Barazinë Gjinore.*

21 · Komunikimi nga Komisioni tek Parlamenti Evropian, Këshilli, Komiteti Evropian Ekonomik dhe Shoqëror dhe Komiteti për Regionet e 21 shtatorit 2010. Strategjia për barazi gjinore në mes të grave dhe burrave 2010-2015 [COM(2010) 491.

22 · Komisioni Evropian, DG Justice - Unit D2 Barazia Gjinore. Kontrata me nr ref. nVC/2010/0592. *Roli i Burrave në Barazi Gjinore – Strategjitë dhe Pikëvështrimet Evropiane.*



Babai më i
MIRË

Babai më i
MIRË



Parakushtet Normative dhe Rregullative dhe Praktikat e Kujdesit Atëror në Ballkanin Perëndimor

Dispozitat Kushtetuese për Barazi Gjinore

KROCIA	Neni 3	Liria, te drejtat e barabarta, barazia gjinore dhe kombëtare, ndërtimi i paqes, drejtësia shoqërore, respekti për të drejtat e njeriut, pacenueshmëria në pronësi, ruajtja e natyrës dhe ambientit, sundimi i ligjit dhe sistemi shumë-partiak demokratik, janë vlerat më të larta të rregullit kushtetues të Republikës së Kroacisë.
	Neni 14	Të gjithë personat në Republikën e Kroacisë do t'i gëzojnë të drejtat dhe liritë, pa dallim race, ngjyre, gjinie, gjuhe, feje, politike apo bindje të tjera, nacionalitet apo origjinë shoqërore, prone, lindjes, arsimimit, status shoqëror apo karakteristikave të tjera. Të gjithë personat do të jenë të barabartë para ligjit.
BOSNJA DHE HERCEGOVINA	Neni 2	Federata do të siguroj zbatimin e nivelit më të lartë të të drejtave dhe lirive të njohura ndërkombëtarisht, të siguruara në dokumentet e listuara në Shtojcën e Kushtetutës. Në veçanti: (1) Të gjithë personal brenda territorit të Federatës do të kënaqin të drejtën: (a) për të jetuar (b) për të qenë i lirë, ku arrestimi dhe paraburgim të lejuar vetëm nga ligji; (c) për të qenë i barabartë para ligjit; (d) për të i lirë nga diskriminimi bazuar në racë, ngjyrë, seks, gjuhë, fe apo besim, politike apo opinione të tjera, dhe origjina kombëtare apo shoqërore; ... (j) për mbrojtje të familjes dhe të fëmijëve...

SERBIA	Neni 1	Republika e Serbisë është shtet i popullit serb dhe të të gjithë qytetarëve që jetojnë në të, bazuar në sundimit të ligjit dhe drejtësisë shoqërore, parimeve të demokracisë civile, të drejtave dhe lirive të njeriut dhe minoriteteve, dhe përkushtimit të parimeve dhe vlera evropiane.
	Neni 15	Shteti do të garantoj barazinë ndërmjet grave dhe burrave dhe do të zhvilloj politika për mundësi të barabarta.
	Neni 21/3	Të gjitha format e diskriminimit të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë bazuar në çfarëdo baze, qoftë në bazë racore, të seksit, origjinës kombëtare, origjinës shoqërore, lindjes, fesë, politikës apo opinionëve të tjera, statusi në pronë, kulturës, gjuhës, moshës, aftësive të kufizuara mendore apo fizike, do të ndalohen.
	Neni 21/4	Masa të veçanta që Republika e Serbisë mund të paraqes për të arritur barazi të plotë për individë apo grupe të individëve në një pozitë thelbësisht të pabarabartë në krahasim me qytetarët e tjerë, nuk do të duhej të konsiderohet diskriminim.
	Neni 65/1	Prindërit do të jenë të drejtën dhe detyrën të përkrahin, dhe të ofrojnë edukim dhe arsimim për fëmijët të cilët do të jenë të barabartë.
	Neni 66/1	Familjet, nënat, prindërit vet-ushqyes dhe cilido fëmijë në Republikën e Serbisë do të gëzojnë mbrojtje të veçantë në Republikën e Serbisë në përputhje me ligjin.

KOSOVA	Neni 3/2	Ushtrimi i autoritetit publik në Republikën e Kosovës do të bazohet në parimet e barazisë për të gjithë individët para ligjit dhe me respekt të plotë për të drejtat dhe liritë e njeriut të njohura ndërkombëtarisht, si dhe mbrojtjen e të drejtave dhe pjesëmarrjes së të gjitha komuniteteve dhe anëtarëve të tyre.
	Neni 7/1	Rregulli kushtetues i Republikës së Kosovës bazuar në parimet e lirisë, paqes, demokracisë, barazisë, respektit për të drejtat dhe liritë e njeriut dhe sundimit të ligjit, jo-diskriminimin, të drejtën për pronë, mbrojtjen e ambientit, drejtësisë shoqërore, pluralizmit, ndarjes së pushtetit shtetëror, dhe ekonomisë së tregut.
	Neni 7/2	Republika e Kosovës siguron barazinë gjinore si vlerë themelore për zhvillimin demokratik të shoqërisë, duke ofruar mundësi të barabarta për pjesëmarrje të grave dhe burrave në jetën politike, ekonomike, shoqërore, kulturore dhe fushave të tjera të jetës shoqërore.
	Neni 22	Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut të garantuara përmes marrëveshjeve dhe instrumenteve ndërkombëtare në vijim garantohen me këtë Kushtetutë, janë në mënyrë të drejtpërdrejtë të zbatueshme në Republikën e Kosovës dhe, në raste konflikti, kanë prioritet mbi dispozitat e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike: (1) Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut; (2) Konventa Ndërkombëtare për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe të drejtave Themelore dhe Protokolleve; (3) Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike dhe Protokollet e tyre; ... (6) Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit kundër Grave; (7) Konventa për të Drejtat e Fëmijëve;

SHQIPËRIA	Neni 18/1	Të gjithë janë të barabartë para ligjit.
	Neni 18/2	Askush nuk do të diskriminohet padrejtësisht, si p.sh. në bazë të gjinisë, racës, fesë, etnisë, gjuhës, besimit politik, fetar apo filozofik, gjendjes ekonomike, arsimit, statusit shoqëror, apo përkatësisë prindërore.

Legjislacioni Kundër-Diskriminimit

KROACIA ²³	Bazat	Përkatësia në bazë racore apo etnike, ngjyre, gjinie, gjuhe, religjioni, politike apo besime të tjera, origjinës kombëtare apo sociale, pronës, anëtarësisë në sindikata, arsimit, statusit social, statusit martesor apo familjar, moshës, gjendjes shëndetësore, aftësive të kufizuara, trashëgimisë gjenetike, të shprehurit apo orientimit seksual.
	Përkufizimi	Pozicionimi i një personi të afërt (të lidhjes familjare apo raporti tjetër) në pozitë më pak të favorshme bazuar apo përmendur në bazë të keqkuptimit të ekzistencës së këtyre bazave
	Format e Diskriminimit	Diskriminimi i drejtpërdrejtë dhe i tërthortë, ngacmimi, ngacmimi seksual, inkurajimi për diskriminim, ndarja, diskriminimi i shumëfishtë, dhe viktimizimi.
	Fushat e shprehura në mënyrë specifike	Puna, shkollimi, sigurimi shoqëror dhe mirëqenia sociale, shëndeti, gjyqësori dhe administrate, strehimi, informacioni publik dhe media, qasje në produkte dhe shërbime, anëtarësimi në sindikata, OJQ, parti politike dhe organizata të tjera, dhe qasja në kulturë e art.
	Institucioni Përgjegjës	Avokati i Popullit

23 - Akti kundër Diskriminimit, Nr. 71-05-03/1-08-2

BOSNJA DHE HERCEGOVINA ²⁴	Bazat	Raca, ngjyra e lëkurës, gjuha, feja, përkatësia etnike, origjina kombëtare dhe sociale, lidhja me një minoritet kombëtar, politik apo ndonjë bindje tjetër, prona, anëtarësimi në sindikata apo asociacion tjetër, shkollit, statusit social dhe seksit, të shprehurit apo orientimit seksual, rrethana të tjera
	Përkufizimi	Secili trajtim i mundshëm përfshirë përjashtimin, kufizimin apo preferencën bazuar në baza reale apo të supozuara me qëllim apo pasojë për të e pamundësuar apo rrezikuar të gëzuarit e të drejtave dhe lirive në të gjitha fushat e jetës publike.
	Format e Diskriminimit	Ngacmimi, ngacmimi seksual, ndarja, udhëzime për të diskriminuar apo për t'iu ndihmuar të tjerëve për të diskriminuar, nxitje për diskriminim
	Fushat e shprehura në mënyrë specifike	Punësim dhe punë, shkollim dhe trajnime, shkencë dhe sport, mbështetje sociale, shëndetësi, gjyqësi dhe administratë, strehim dhe informacion publik dhe media, anëtarësi në organizata profesionale, përfshirë anëtarësinë në organizatat e të punëdhënësve dhe të punëtorëve, mallra dhe shërbime, ndërmarrësi, kultur dhe art, jetën publike, familje, të drejtat e fëmijëve.
	Institucioni Përgjegjës	Avokati i Popullit
SERBIA ²⁵	Bazat	Raca, ngjyra e lëkurës, të paraardhësit, nënshtrësitë, përkatësia kombëtare apo origjina etnike, gjuha, feja apo besimet politike, gjinia, identiteti gjinor, orientimi seksual, pozita financiare, lindja, karakteristikat gjenetike, shëndeti, aftësitë e kufizuara, statusi martesor dhe familjar, dënimet e mëparshme, mosha, dukja, anëtarësim në organizata politike, sindikata dhe organizata të tjera, dhe karakteristika të tjera personale, reale apo të supozuara
	Përkufizimi	Çfarëdo trajtimi të pabarabartë, që do të thotë përjashtim, kufizim, apo trajtim i preferuar në lidhje me individët apo grupe, si dhe anëtarët e familjeve të tyre apo personat e tyre të afërt, qoftë hapur apo fshehtë, mbi bazat e përmendura.
	Format e Diskriminimit	Diskriminimin e drejtpërdrejtë dhe të tërthortë, si dhe shkeljen e principit të të drejtave dhe obligimeve të barabarta, duke thirrur në llogari, që asociohet me qëllimin e ushtrimit të diskriminimit, gjuhës së urrejtjes dhe trajtimit poshtërues, formave të vrazhda diskriminuese.
	Fushat e shprehura në mënyrë specifike	Gjyqet e ligjeve dhe administratës publike, punës dhe punësimit, shërbimeve publike, përdorimit të premisave dhe hapësirave, diskriminimit fetar, edukimit dhe trajnimeve profesionale, gjinisë, orientimit seksual, të drejtave të fëmijëve, moshës, minoriteteve kombëtare, partive politike dhe anëtarësisë në sindikata, aftësive të kufizuara, shëndetit.
	Institucioni Përgjegjës	Komisioneri për Mbrojtjen e Barazisë

24 · "Gazeta Zyrtare e Federatës së Bosnje dhe Hercegovinës" Nr. 59/09.

25 · "Gazeta Zyrtare e Republikës së Serbisë" Nr. 22/2009.

KOSOVA²⁶

Bazat	Seksit, gjinisë, moshës, statusit martesor, gjuhës, aftësive të kufizuara mendore dhe fizike, orientimit seksual, përkatësisë politike apo bindjeve, origjinës etnike, nacionalitetit, fesë apo besimit, racës, origjinës shoqërore, pronësisë, lindjes apo status tjetër.
Përkufizimi	Parimet e trajtimit të barabartë do të nënkuptojnë që nuk do të ketë diskriminim direkt apo indirekt kundër cilitdo person apo personave mbi bazat e përmendura.
Format e Diskriminimit	Diskriminimit direkt dhe indirekt, ngacmimit, udhëzimeve për të diskriminuar, viktimizimit, ndarjes
Fushat e shprehura në mënyrë specifike	Punësimit, vet-punësimit dhe profesionit, udhëzimit profesional, trajnimit profesional, kushteve të punës, anëtarësimit në organizata të punëdhënësve dhe të punëtorëve, mbrojtjes sociale, avantazheve sociale, edukimit, strehimit, produkteve dhe shërbimeve, tribunaleve dhe të gjitha organeve të tjera që administrojnë drejtësinë, sigurinë personale, marrëdhëniet me publikun dhe vendeve.
Institucioni Përgjegjës	Organet administrative dhe gjykatat kompetente të cilat kanë jurisdiksion për çështjet konkrete të përfshira në ankesë.

SHQIPËRIA²⁷

Bazat	Gjinisë, racës, ngjyrës, etnisë, gjuhës, identitetit gjinor, orientimit seksual, politik, fetar apo besimet filozofike, ekonomike, arsimore apo situatave shoqërore, shtatzënia, përkatësia prindërore, përgjegjësia prindërore, moshë, familja apo gjendja martesore, statusit civil, rezidencës, statusit shëndetësor, predispozitave gjenetike, aftësive të kufizuara, përkatësisë të një grupi të veçantë apo çfarëdo arsye tjetër.
Përkufizimi	Secili dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë sepse në bazat e përmendura që ka për qëllim apo pasojë të pengojnë apo pamundësojnë ushtrimin, në të njëjtën mënyrë sikurse të tjerët, si të drejtat dhe liritë themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, me akte ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë si dhe me ligjet në fuqi.
Format e Diskriminimit	Diskriminim të drejtpërdrejtë apo të tërthortë për shkak të asociimit, bezdisë, mohimit të një akomodimi të arsyeshëm, viktimizimit
Fushat e shprehura në mënyrë specifike	Reklama diskriminuese, pjesëmarrje në politikë, vetëdije e religjion, punësim dhe përzgjedhje të të punësuarve, trajtimi i të punësuarve në vendin e punës, anëtarësisë në sindikata dhe dobëti e mundshme nga lehtësirat që ky anëtarësim siguron.
Institucioni Përgjegjës	Këshilli i Ministrave dhe Ministrat të Arsimit dhe Shkencës

26 - Ligji Kundër Diskriminimit Nr. 2004/ 3.

27 - Ligji Nr. 10 221 për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Legjislacioni për Barazi Gjinore

BOSNJA DHE HERCEGOVINA	Fushat me Interes të Veçantë	edukimi, punësimi, puna dhe qasja në resurse, mirëqenie sociale, kujdes shëndetësor, sport dhe kulturë, jeta publike, media, parandalimi i dhunës, të dhënat statistikore, mbrojtja gjyqësore, kompensimi i dëmeve, përgjegjësitë e autoriteteve, monitorimi i zbatimit të ligjit
	Relevante për Atësinë	Neni 8 Ndalohen: · trajtimi i ndryshëm i grave dhe burrave për pushimin pas lindjes; · cilito trajtim jo i favorshëm në pajtimin rreth obligimeve profesionale dhe familjare Neni 13 E njëjta e drejtë për kujdes shëndetësor, qasje në shërbime shëndetësore, përfshirë planifikimin familjar
	Relevante për Promovimin Potencial të Atësisë Aktive	Neni 6: Plan-programe mësimore dhe metodologji për të themeluar një sistem arsimor që përfshin garantimin për eliminimin e programe mësimore me stereotipe që prodhojnë diskriminim dhe pabarazi gjinore si pasojë. Materialet që promovojnë barazinë gjinore do të jetë pjesë integrale e programit mësimor për të gjitha nivelet e shkollimit. Neni 17 Zhvillimi i masave për parandalimin e dhunës në bazë gjinore, për të eliminuar anshmëritë, traditat dhe të gjitha praktikatat që bazohen në idenë e inferioritetit apo superioritetit të cilitdo seks, si dhe roleve të stereotipizuara për burrat dhe gratë. Kjo përfshin por nuk kufizohet në edukim dhe ngritjen e vetëdijes së shërbyesve civilë, publikut, etj.
SERBIA	Fushat me Interes të Veçantë	Punësimi, kujdesi shoqëror dhe shëndetësor; lidhjet familjare; shkollimi; kultura dhe sportet; jeta politike dhe publike; mbrojtja gjyqësore; mbikëqyrja e zbatimit të ligjit;
	Relevante për Atësinë	Neni 28 E drejta për kujdesin shëndetësor dhe pranimin e shërbimeve mjekësore që lidhet me planifikimin familjar Partnerët janë të barabartë në planifikimin e numrit të fëmijëve, qasjes në informacion, shkollim dhe mjete që u mundësojnë atyre t'i ushtrojnë këto të drejta.
	Relevante për Promovimin Potencial të Atësisë Aktive	Neni 7 Masa të veçanta që synojnë eliminimin e pabarazive nuk konsiderohen diskriminim. Neni 31 Edukim për barazi gjinore si pjesë integrale e nivelit parashkollor, shkollimit fillor, të mesëm e universitar, si dhe si pjesë integrale e edukimit të përhershëm për t'i tejkaluar rolet e kufizuara gjinore, çlirim nga stereotipet në bazë gjinore dhe paragjyqimeve në bazë gjinore Organet e administratës shtetërore për edukim do të sigurojnë që politikatat për mundësi të barabarta po zbatohen.





SERBIA

Relevante për Promovimin Potencial të Atësisë Aktive	Neni 41 Informacioni për mas media (përfshirë reklamat) nuk duhet të përmbajnë apo ta inkurajojnë diskriminimin në bazë gjinore dhe mas media duhet të zhvillojnë vetëdijesimin për barazinë gjinore në programet e tyre, si dhe të ndërmarrin masa të mjaftueshme për t'i ndryshuar modelet shoqërore dhe kulturore, traditat dhe cilëndo praktikë tjetër që përcakton stereotipe, paragjykime dhe diskriminim.
--	--

KROACIA

Fushat me Interes të Veçantë	Punësimi dhe profesioni, shkollimi, partitë politike, media, të dhënat statistikore, zbatim i aktit, sigurimi i fondeve, mbrojtje gjyqësore
Relevante për Atësinë	Neni 13 Nuk do të ketë diskriminim në fushën e punësimit dhe profesione në sektorin publik dhe privat, përfshirë organet publike, për të balancuar jetën profesionale me privaten; shtatzëni, lindje, prindërim dhe çfaredo forme të kujdestarisë.
Relevante për Promovimin Potencial të Atësisë Aktive	Neni 3 · Obligimi i institucioneve për të zbatuar analizën gjinore · Obligimi i institucioneve relevante për të zbatuar trajnime për barazi gjinore për stafin e tyre Neni 9 Masa special që synojnë eliminimin e pabarazive që nuk konsiderohen diskriminim Neni 11 · Obligimi i institucioneve relevante për të zbatuar masa të veçanta dhe për të adoptuar plane veprimi për promovimin dhe themelimin e barazisë gjinore në bazë të analizës së statusit të grave dhe burrave çdo katër vite dhe në lidhje me masat e Politikave Kombëtare · Institucionet relevante dhe personat ligjorë me më shumë se njëzet të punësuar do të inkorporojnë dispozita dhe masa kundër-diskriminuese për të arritur barazi gjinore në aktet e përgjithshme · Tiparet sociale do të përputhen me dispozitat e këtij Akti dhe me masat e synuara për të siguruar barazi gjinore Neni 14 · Çështjet që lidhen me barazi gjinore do të jenë pjesë themelore e nivelit parashkollor, fillor dhe të mesëm, si dhe arsimit universitar me të mësuarit gjatë gjithë jetës, dhe trajnimeve shtesë Neni 16 Mediet do të përdorin programin e tyre, kornizën programore, udhëzimet programore dhe aktet vet-rregullatore për të promovuar barazinë ndërmjet grave dhe burrave

Fushat me
Interes të
Veçantë

Organet përgjegjëse për arritje të ligjit, financimi i organeve përgjegjëse, mbledhja e informacionit dhe statistikat gjinore, partitë politike, shoqëria civile, ekonomia, punësimi, edukimi, media, të drejtat civile, dispozitat ndëshkuese, zgjidhjen e konflikteve dhe sanksioneve

Relevante
për Atësinë

Seksioni 13

- Punëdhënësit marrin të gjitha masat e nevojshme për tu mundësuar burrave dhe grave të i përgjigjen edhe obligimeve të tyre profesionale, edhe atyre familjare.
- Puna e papaguar e grave dhe burrave konsiderohet si kontribut i zhvillimit të familjes dhe shoqërisë në rastet kur:
 - a) Kujdesi për mirëqenien e familjes;
 - b) Kujdesit për fëmijën

Relevante për
Promovimin
Potencial të
Atësisë Aktive

Seksioni 14

Organet dhe institucionet kompetente në fushën e edukimit të të gjitha niveleve do të themeloj, zbatoj dhe mbikëqyr politikat me qëllim të sigurimit të barazisë gjinore, posaçërisht kur është fjala për barazinë gjinore, edukimin, hulumtimin për statusin e gjinive në Kosovë, si metodë specifike në edukim.

Seksioni 15

- Të gjitha mediat do të promovojnë barazinë përmes: ... programeve edukative, duke promovuar rolin e barabartë të grave e burrave në shoqëri, duke ofruar informacion të saktë dhe të kompletuar për barazinë gjinore.
- Transmetimi dhe publikimi i programeve, materialeve dhe informacionit me diskriminim gjinor ndalohet

Neni 25

- Institucionet arsimore përgjegjëse do të sigurojnë që mësimdhënia ndihmon në promovimin dhe ndërtimin e mentalitetit të barabartë dhe në parandalimin e diskriminimit gjinor, stereotipeve negative, paragjyqimeve
- Institucionet e arsimit të lartë ndërmarrin iniciativa për studime në fushën e barazisë gjinore, apo e përfshijnë atë në plan-programin aktual mësimor, për të siguruar material me informacion relevant, si dhe për të vazhduar me zhvillimin praktik dhe shkencor në këtë fushë.

Neni 26

Media ndihmon në ngritjen e vetëdijes së përgjithshme të barazisë ndërmjet grave dhe burrave duke mos diskriminuar në bazë gjinore gjatë raportimit; zbatimin e terminologjisë neutrale gjinore; dhe shmangien e stereotipeve gjinore përmes aktivitetëve të tyre.

Fushat me
Interes të
Veçantë

organet përgjegjëse për arritjen e barazisë gjinore, procesit vendimmarrës, relacioneve të punës, edukimit

Neni 9

Masa të veçanta që synojnë: të ofrojnë mbrojtje të veçantë për ... prindërit e rinj si rezultat i lindjes së tyre natyrale apo birësimit të fëmijës ...; lehtësimit dhe asistimit të personave që kanë përgjegjësi të veçanta në familjet e tyre për shkak të kujdesit ditor për anëtarët me aftësi të kufizuara; nuk konsiderohen diskriminim

Neni 17

Veprimet e punëdhënësit në sektorin publik apo privat do të jenë diskriminuese nëse bazohen në gjininë që punëdhënësi përdor standarde të diferencuara dhe/ apo procedura drejt punëdhënësit në lidhje me ... të drejtën për pushim dhe pushim me pagesë...

Relevante
për Atësinë

Neni 21

Të punësuarit femra dhe meshkuj do t'i kenë të drejtat në vijim pa diskriminim gjinor ... për të gëzuar mbrojtje shëndetësore dhe siguri në punë, përfshirë mbrojtjen e funksionit riprodhues ...; të kenë mbështetje të nevojshme dhe inkurajim të shërbimeve nga sistemi social për tu lejuar prindërve të punësuar për t'i balancuar obligimet familjare me përgjegjësitë profesionale.

Neni 23

Puna pa pagesë për burrat dhe gratë nuk do të konsiderohet kontribut i familjes dhe shoqërisë në rastet kur ai/ajo:

- a) kujdeset për mirëqenien e familjes;
- b) kujdeset për fëmijët;
- c) kujdeset për anëtarët e tjerë të familjes ...

Relevante për
Promovimin
Potencial të
Atësisë Aktive

Neni 7

Për të siguruar barazi gjinore dhe për të eliminuar diskriminimin me bazë gjinore, agjencitë relevante qeveritare do të përkushtohen për të: siguruar zbatim praktik të parimit të barazisë gjinore, të sigurojnë parandalim të cilitdo lloji të diskriminimit gjinor; të sigurojnë ndryshimin apo refuzimin e cilitdo akt ligjor, zakon apo praktikë që shkakton diskriminim gjinor; duke i marrë të gjitha masat e përshtatshme për të krijuar lehtësira objekte ligjore për të dy gjinitë kundër cilitdo veprim diskriminues përmes institucioneve publike dhe gjyqeve kombëtare.

Neni 8

Masa të veçanta që synojnë eliminimin e pabarazive nuk konsiderohen diskriminim.

E Drejta për Pushim Prindëror

KROACIA ²⁸		Pushimi i lehonisë: 45 ditë para datës së lindjes deri sa fëmijë të jetë jashtë muaj (Neni 12) Pushimi i obliguar i lehonisë: 28 ditë deri në 42 ditë që na lindja e fëmijës (Neni 12) Pushimi i atësisë: Pas përfundimit të pushimit të obliguar të lehonisë, nëse prindërit pajtohen, e drejta për pushim të lehonisë mund të përdoret nga babai i fëmijës (Neni 12) Pushimi prindëror (për të dy prindërit, deri në vitin e gjashtë të fëmijës): jashtë muaj – 3 për prindin (Neni 13, 14), Për binjakë, fëmijën e tretë dhe cilindo fëmijë tjetër: 30 muaj – 15 për prind (Neni 14) Masat për veprime afirmative: nëse babai e përdor pushimin prindëror për minimum 3 muaj, pushimi zgjatet për 2 muaj më shumë (Neni 14) Pushimi prindëror: nëse një prind vdes, dhe nuk mund të kujdeset për fëmijën, prindi tjetër do të mund t'i përdor të gjitha të drejtat e ndërlidhura (Neni 18) Kujdesi ndaj fëmijës – prindërit: Pas kalimit të pushimit të obliguar, të drejtën për të punuar gjysmën e orëve normale të punës derisa fëmija bëhet 6 muaj (Neni 15) Fëmija në nevojë për kujdes më të madh – një prind: Pas pushimit prindëror, të drejtën për të punuar gjysmën e orëve të plota të punës derisa fëmija të bëhet tre vjet (Neni 16) Prindërit birësues: 6 muaj derisa fëmija është 18 vjeç (Neni 36)
BOSNJA DHE HERCEGOVINA	FEDERATA E BOSNJE DHE HERCEGOVINËS ²⁹	Pushim për lindje: shtatë ditë (Neni 53) Pushimi i lehonisë: 28 ditë para datës së lindjes e deri në një vjet (Neni 62) Pushim i obliguar i lehonisë: 42 ditë para lindjes (Neni 62) Pushimi prindëror: Pas kalimit të pushimit të obliguar të lehonisë, nëse prindërit pajtohen, e drejta për pushim të lehonisë mund të përdoret nga babai i fëmijës (Neni 62) Pushimi i atësisë: Nëse nëna e fëmijës ka vdekur apo e ka braktisur një fëmijë, apo për arsye të tjera shfajësuese nuk ka mundësi të kujdeset për fëmijën, të drejtat janë të njëjta si për nënën (Neni 62) Kujdesi për fëmijën – nëna: Pas pushimit të lehonisë, të drejtën për gjysmën e orarit të rregullt të punës derisa fëmija të bëhet 2 vjeç (Neni 63) Kujdesi për fëmijën – babai: Të njëjtat të drejta nëse nëna po punon me orar të plotë gjatë kësaj kohe (Neni 63) Fëmija në nevojë për kujdes më të madh – njëri prind: Pasi që fëmija bëhet një vjeç, të drejtën për të punuar gjysmën e orëve të plota të punës derisa fëmija të jetë tre vjeç (Neni 64) Fëmija me problem të mëdha zhvillimore – njëri prind (vetushqyes/ të dy prindërit e punësuar): E drejta për të punuar 50% të orarit të plotë të punës (Neni 69) Prindërit birësues apo ata kujdestarë: të njëjtat sikurse për nënën (Neni 70)
	REPUBLIKA SRPSKA ³⁰	Pushim me pagesë për lindjen e fëmijës: Shtatë ditë të punës (Neni 77) Pushim me pagesë për lindje: Shtatë ditë punë (Neni 77) Pushimi i lehonisë dhe i kujdesit ndaj fëmijës: 45 ditë para datës së lindjes, e deri në 365 ditë (Neni 94) Për fëmijën e tretë dhe cilindo fëmijë pasues – deri në dy vite gjithsej (Neni 94a) Pushimi i obliguar i lehonisë: 28 ditë para se fëmija të jetë 3 muaj (Neni 94) Kujdesi ndaj fëmijës – nëna: Që nga dita e fillimit të pushimit të lehonisë e deri në 365 ditë (Neni 94) Pushimi prindëror: Pas përfundimit të pushimit të obliguar të lehonisë, e drejta për kujdesin ndaj fëmijës (Neni 94) Pushimi i atësisë: Nëse nëna e fëmijës ka vdekur apo e ka braktisur një fëmijë, apo për çfarëdo arsye të justifikueshme nuk është në gjendje të kujdeset për fëmijën, të drejtat janë të njëjta si të nënës (Neni 94) Fëmija me probleme zhvillimore – njëri prind: Pas përfundimit të pushimit të lehonisë dhe pushimit për kujdesin ndaj fëmijës, të drejtën për të munguar në punë, apo për të punuar me gjysmë orari, më së shumti derisa fëmija të jetë pesë vjeç (Neni 96) Prindërit birësues/kujdestarët: Të drejtën për të munguar në punë për tetë muaj, që nga dita kur fëmija përcjellët më një familje birësuese apo kujdestare, dhe më së shumti derisa fëmija të jetë pesë vjeç (Neni 97) Kur strehimi të ketë ndodhur para se fëmija të bëhet tre vjeç, e drejta për të munguar derisa fëmija të bëhet 11 muaj (Neni 97)

SERBIA³¹

Pushim me pagesë për lindjen e fëmijës: Shtatë ditë të punës (Neni 77)
 Pushim me pagesë për lindje: Shtatë ditë punë (Neni 77)
 Pushimi i lehonisë dhe i kujdesit ndaj fëmijës: 45 ditë para datës së lindjes, e deri në 365 ditë (Neni 94) Për fëmijën e tretë dhe cilindo fëmijë pasues – deri në dy vite gjithsej (Neni 94a)
 Pushimi i obliguar i lehonisë: 28 ditë para se fëmija të jetë 3 muaj (Neni 94)
 Kujdesi ndaj fëmijës – nëna: Që nga dita e fillimit të pushimit të lehonisë e deri në 365 ditë (Neni 94)
 Pushimi prindëror: Pas përfundimit të pushimit të obliguar të lehonisë, e drejta për kujdesin ndaj fëmijës (Neni 94)
 Pushimi i atësisë: Nëse nëna e fëmijës ka vdekur apo e ka braktisur një fëmijë, apo për çfarëdo arsye të justifikueshme nuk është në gjendje të kujdeset për fëmijën, të drejtat janë të njëjta si të nënës (Neni 94)
 Fëmija me probleme zhvillimore – njëri prind: Pas përfundimit të pushimit të lehonisë dhe pushimit për kujdesin ndaj fëmijës, të drejtën për të munguar në punë, apo për të punuar me gjysmë orari, më së shumti derisa fëmija të jetë pesë vjeç (Neni 96)
 Prindërit birësues/kujdestarët: Të drejtën për të munguar në punë për tetë muaj, që nga dita kur fëmija përcjellët më një familje birësuese apo kujdestare, dhe më së shumti derisa fëmija të jetë pesë vjeç (Neni 97)
 Kur strehimi të ketë ndodhur para se fëmija të bëhet tre vjeç, e drejta për të munguar derisa fëmija të bëhet 11 muaj (Neni 97)

KOSOVA³²

Pushim me pagesë lindje të fëmijës apo adoptim: Dy ditë pune (Neni 50)
 Pushim pa pagesë për lindje të fëmijës apo adoptim: Dy javë në secilën kohë para se fëmija të arrij moshën tre vjeçare (Neni 50)
 Pushimi i lehonisë: 45 ditë e deri në 12 muaj (për 6 muajt e parë – komensimi është 70% e rrogës bazë, në tre muajt e ardhshëm – kompensimi është 50% e pagës së përafërt, tre muajt e fundit – pa pagesë) (Neni 49)
 Pushim i obliguar i lehonisë: 28 ditë para datës së lindjes, deri në 6 muaj (Neni 49)
 Pushimi prindëror: Pas kalimit të pushimit të obliguar të lehonisë, nëse prindërit pajtohen, të drejtën për pushim të lehonisë mund ta shfrytëzoj edhe babai (Neni 49)
 Pushimi i atësisë: Nëse nëna e fëmijës ka vdekur apo e ka braktisur fëmijën, apo për arsyeshmëri tjetër nuk ka mundësi të kujdeset për fëmijën e saj, të drejtat janë të njëjta si të nënës (Neni 49, 50)
 Fëmija në nevojë për kujdes për të madh – një prind: Pas kalimit të pushimit të lehonisë, e drejta për të punuar gjysmën e orarit të plotë derisa fëmija është dy vjeçar (Neni 52)

28 · Akti për Përfitimet e Lehonisë dhe Prindërit, NN 85/08,110/08,34/11,54/13,152/14.

29 · "Gazeta Zyrtare e Federatës së Bosnje dhe Hercegovinës" Nr. 62/15.

30 · "Gazeta Zyrtare e Republika Srpska", Nr. 38/00.

31 · "Gazeta Zyrtare e RS", No. 24/2005, 61/2005, 54/2009, 32/2013, dhe 75/2014.

32 · Ligji Nr. 03/L-212 për Punë, <http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2010-212-eng.pdf>.

Pushimi i atësisë për punonjësit meshkuj në administratën publike: 3 ditë¹
 Pushimi i lehonisë: 35 ditë e deri në 365 ditë (Neni 27, Ligji për Sigurimin Shoqëror)
 Për më shumë se një fëmijë: 60 ditë paraprakisht, e deri në 390 ditë (Neni 27, Ligji për Sigurim Shoqëror)
 Pushimi i obliguar i lehonisë: 35 ditë e deri në 42 pas lindjes (Neni 104, Kodi i Punës)
 Për më shumë se një fëmijë: 60 ditë e deri në 42 pas lindjes (Neni 104, Kodi i Punës)
 Nën at birësuese: Kur një fëmijë deri në moshën një vjeçare birësohet, e drejta për dobitë amënore duke filluar nga dita e birësimit, por jo para ditës së 42të të lindjes, i nënshtrohet në maksimum 330 ditëve nga lindja e fëmijës.
 Periudha e minimumit të përfitimeve është 28 ditë (Neni 27)
 Granti për lindje – një fëmijë (nënat kanë prioritet): Granti për lindje do të jetë një shumë e plotë e barabartë me 50% të pagës mujore, e siguruar për një prind që ka kontribuar për një vit para lindjes së fëmijës (Neni 29)

33 · Ligji Nr 7961 për Punën; Ligji, No. 7703 për Sigurinë Sociale; The Council of Minster Decision Nr. 511 për "Orët e Punës dhe Pushimin në Administratën Publike".

34 · Sipas *Council of Minster Decision* Nr. 511 i datës 24 tetor 2002 "Për Orët e Punës dhe pushimin në Administratën Publike"



Babai më i
MIRË

Babai më i
MIRË



Praktikat e Kujdesit Atëror në Ballkanin Perëndimor

Përfshija e Burrave në Kujdesin e Fëmijëve dhe në Punë Shtëpie >

“Edhe pse kujdesi për fëmijët dhe pjesëmarrja në punë të shtëpisë nuk është pjesë e rolit tradicional gjinor për një burrë, ka indikatorë që burrat sot, më shumë sesa në të kaluarën, marrin pjesë në këto aktivitete. Çështja e ndarjes së punëve të shtëpisë dhe përkujdeses ndaj fëmijëve lidhet me një ndryshim të madh shoqëror në shekullin e kaluar, që është pjesëmarrja e grave në tregun e punës. Si rrjedhojë, pritet që, pasi që gratë janë të punësuar, burrat duhet të kalojnë më shumë kohë në punë të shtëpisë, edhe pse ndryshimet në sferën e punës më pagesë kanë qenë më radikale sesa ato në shtëpi.”³⁵ Në një rën anë, studime të shumta që nga vitet 1960ta për punën dhe kohën e lirë në shtëpi kanë treguar që gjërat, në fakt, po ndryshojnë. Në anën tjetër, sferat private ende karakterizohen me mosbalancë të pamasë gjinore, posaçërisht në kujdesin e fëmijëve dhe në punët shtëpiake; dhe ndarja asimetrike e punëve të shtëpisë ende e redukton garën e grave në tregun e punës dhe riprodhon pabarazi ndër gjenerata. Edhe pse ky fakt njihet në mënyrë universale, programe dhe politika të mjaftueshme që promovojnë përfshirjen më të madhe të

burrave në përkujdesje të fëmijëve dhe në punë të shtëpisë, ende mungojnë. Po ashtu, dëshmi gjithëpërfshirëse në praktika dhe trende specifike në këtë fushë ende pritët të mblidhen në mënyrë të vazhdueshme në rajonet e Ballkanit Perëndimor. Për më shumë, komunitetet tona kanë mungesë të madhe në dëshmi për ndikimin e përfshirjes më të madhe të burrave në përkujdesje të fëmijëve dhe në mirëqenien e fëmijëve, që do të shërbente si pikënisje e mirë për avokim aktiv për hartimin e politikave dhe paraqitjen e masave specifike për promovimin e atësisë.

Shembull i praktikave të mira dhe një nga përpjekjet më gjithëpërfshirëse në fushën e mbledhjes së të dhënave që mund të shërben si pikënisje relevante për zhvillimin e politikave dhe projekteve të mjaftueshme është Anketa Ndërkombëtare për Burrat dhe Barazinë Gjinore (ANBBGJ), si komponentë e Projektit për Burrat dhe Barazinë Gjinore koordinuar nga Promundo³⁶ dhe partnerëve të tjerë dhe zbatuar nga viti 2009 deri në 2010 në Brazil, Kili, Kroaci, Indi, Meksikë dhe në Ruanda. Për më shumë, CARE International Balkans përkrahur edhe nga

35 - Qendra për Edukim, Këshillim dhe Hulimtim. (2010). Projekti për Politikën për Burrat dhe Barazinë Gjinore.

36 - <http://promundoglobal.org/programs/international-men-and-gender-equality-survey-images/>

OJQ Perpetuun Mobile – Qendra për Zhvillimin e të Rinjve dhe Komunitetit dhe Qendra për Edukim, Këshillim dhe Hulumentim në Kroaci, ka zbatuar hulumentimin në Bosnje dhe Hercegovinë dhe Kroaci. Kjo anketë për qëndrimet dhe praktikrat e burrave dhe perceptimit të grave për praktikrat e burrave përfshinë një varg temash të ndryshme që lidhen me barazi gjinore dhe posaçërisht, kujdesin atëror dhe praktikrat e punëve të shtëpisë³⁷.

Bazuar në rezultatet e hulumentit të ANBGJ-së, zbatuar në Bosnje dhe Hercegovinë dhe Kroaci, mos-balanca në ndarjen e punës është ende i dukshëm dhe edhe burrat në mënyrë të hapur raportojnë për mungesën e përfshirjes së tyre (sa janë të kënaqur në të njëjtën kohë – “rreth 95% e burrave në Bosnje dhe Hercegovinë janë të kënaqur me ndarjen e punës”³⁸):

Raporti i burrave për pjesëmarrjen në punë të shtëpisë	Lajmë rrobat	Rregullojnë shtëpinë	Blejnjë ushqim	Pastrojnë banjën	Përgatisin ushqim	Paguajnë faturat
Bosnja dhe Hercegovina	21,6	94,6	72,8	35,7	31	83
Kroacia	17	96	74	27	39	76

Edhe pse në mënyrë të tërthort, bazuar në llojet e aktiviteteve të listuara dhe raporti për përfshirjen e burrave, mund të vërehen që burrat janë ende më të përfshirë në aktivitete tradicionale mashkullore – në ambient të jashtëm dhe në detyra që nuk janë përsëritëse; dhe që koha mesatare për ditë e shpenzuar në aktivitete të shtëpisë është më pak sesa për gratë, edhe pse shumica (61%) raportojnë që ata punojnë në mënyrë të barabartë apo edhe më shumë se gratë.

Në të njëjtën kohë, 80% e burrave në Bosnje dhe Hercegovinë dhe 92% e burrave në Kroacia raportojnë për (së paku një) shoqërim gjatë

vizitave të paralindjes, dhe vetëm 7% e burrave në Bosnje dhe Hercegovinë dhe 17% e burrave në Kroaci janë të pranishëm në sallat e lindjes gjatë lindjes së fëmijëve.

Pasi që përcjellja varet në mënyrë të drejtpërdrejtë në politikat e përgjithshme dhe të spitaleve, mes tjerash, prania në sallën e lindjes duhet të jetë një nga temat më të rëndësishme për hartimin e politikave dhe përpjekjeve aktiviste në të kaluarën. Edhe pse ende elementare, praktika e përdorimit të pushimit prindëror, po ashtu mund të shërbej si argument për masa afirmative që shpien drejt promovimit të barazisë gjinore dhe atësisë më

37 · Të dhënat nga ky seksion është prezantuar në detaje në: *Burrat dhe Relacionet Gjinore në Bosnje dhe Hercegovinë*: <http://menengage.org/wp-content/uploads/2014/06/IMAGES-Bosnia1.pdf>; dhe *Burrat në Evolim*: Rezultatet Fillestare nga

Anketa Ndërkombëtare për Burrat dhe Barazinë Gjinore: <http://www.icrw.org/publications/evolving-men>.

38 · Ibid.

aktive. Përkatësisht, 20% e burrave në Bosnje dhe Hercegovinë dhe gati 40% e burrave në Kroaci e kanë përdorur të drejtën e tyre për pushim prindëror me pagesë gjatë lindjes të fëmijës së tij të parë. Në këtë kuptim, efekte pozitive për zbatimin e Aktit të Dobive të Amësisë dhe Prindërimit në Kroaci, ende pritet të

shihen. Sa i përket kujdesit të fëmijëve nën moshën 5 vjeçare (Bosnje dhe Hercegovinë) dhe 4 (Kroaci), burrat në Kroacia janë më të përfshirë në përkujdesin ndaj fëmijëve, dhe burrat edhe në Bosnje e Hercegovinë e edhe Kroaci janë më shumë të përkushtuar të luajnë me fëmijët sesa të gatuajnë për ta:

Raporti i burrave për kujdesin e fëmijëve nën 5/4	Bosnja dhe Hercegovina	Kroatia
Të luajë me fëmijun	68,6	76
Gatui për fëmijë	21,4	45
Ndërroj pelenat për fëmijun	31,0	52

Për të kuptuar idenë nëse situata në Serbi i përcjell trendet e vërejtura në Bosnje dhe Hercegovinë dhe Kroaci, për qëllim të këtij punimi shqyrtues, ne organizuam një diskutim në fokus grup me baballarë aktivë dhe të angazhuar. Një përmbledhje e përgjithshme e të gjeturave kryesore dëshmojnë që dinamikat e njohura janë prezantuar edhe në Serbi. Përkatësisht, nëse analizojmë në thellësi inputet e mbledhura nga diskutimi, përcjellja do të ishte e rëndësishme për eksplorim të mëturtyeshëm të situatës aktuale.

Të gjithë të anketuarit kanë demonstruar përkushtim në prindërim si dhe në rëndësinë e rolit të babait në jetën e tyre si pjesë e rëndësishme e identitetit personal. Në këtë pikë, ata kanë perceptuar të njëjtën rëndësi të lidhjeve me partner, të cilën ata e konsiderojnë si bazë për prindërim të suksesshëm. Ata i shohin partneret si të barabarta, homolog në të gjitha sferat e jetës përfshirë prindërimin. Ata e perceptuan barazinë gjinore si vlerë të rëndësishme, besim personal i cili inkorporohet në jetën e përditshme dhe në rritjen e fëmijëve. Për më shumë, ata theksuan qartë mosmarrëveshjet (përfshirë

neverinë) me konceptet dominuese në shoqëri, që i prezantojnë burrat si dominues për gratë, i quajtën ata "primitivë, konservatorë, tipare démodé, që nuk mund t'iu mbijetojnë sfidave të jetës modern". Për më shumë, sipas tyre, barazia gjinore është rezultat praktik i sfidave me të cilat përballemi të gjithë për të arritur një nivel të caktuar të jetës cilësore. Është vështirë të menaxhohet mënyra cilësore e të jetuarit, nëse nëna po qëndron në shtëpi, e papunësuar. Në anën tjetër, nëse ajo është e punësuar, nënkupton që është e nevojshme për të ndarë detyrat ndërmjet partnerëve në bazë ditore dhe të marrin pjesë në mënyrë të barabartë në vendimmarrjen familjare. Prindërimi cilësor dhe i përgjegjshëm shtrihet në supozimet për barazi gjinore.

Analizimi i nivelit të pajtueshmërisë të partnerëve, është e qartë që e gjitha tregon pajtim për çështjet më të rëndësishme dhe ato me prioritet, perceptimin për botën, përfshirë ndarjen e vlerave të njëjta. Prapë se prapë, u dëshmuua që ata i njihnin disa mos-pajtueshmëri të ngjashme, sikurse stili i komunikimit me botën e jashtë – në socializim, apo dallimet

në komunikim me fëmijët, si dhe në nivelin e të qenurit praktik dhe eficient gjatë përballjes me çështje të veçanta ditore. Stereotipizime të caktuara mund të vëreheshin rreth mosmarrëveshjeve të përgjithshme.

Sa i përket prindërimit, disa të anketuar kanë vërejtur dallimin në mes tij dhe partneres-nënë, në mënyrën se si komunikojnë me fëmijët në situata kur kërkohet zgjidhja e problemit. Derisa ata mundohen të promovojnë qasjen praktike dhe eficiente në zgjidhjen e problemeve, respektimin e kufijve të situatës, nëna kthehet të zhvilloj raporte në bazë emocionale dhe modele tejet mbrojtëse drejt fëmijës. Diskutimi na ka udhëzuar të mendojmë për çështjen e asaj se si perceptohet fëmija nga roli i nënës për dallim nga i babait, posaçërisht për ata fëmijë që janë rritur në familje që promovojnë prindërim të barabartë dhe me përgjegjësi të ndara. Ekziston përshtypja që disa baballarë, në anën tjetër, pavarësisht angazhimit të tyre, nuk ndjehen të barabartë me nënën në terme të mundësive për tu përfshirë në prindërim në të njëjtin nivel – “kur fëmija është i sëmurë ai/ ajo do që nëna ta merr dhe ta qetësoj”. Kjo temë kërkon që të ekzaminohet tutje në të ardhmen. Diskutimi për ndarjen e punës dhe përkujdesjen e fëmijëve ndërmjet partnerëve ofron mundësi për më shumë pikëvështrime rreth trendeve aktuale. Edhe pse të gjithë të anketuarit ka thënë që ata “i ndajnë punët varësisht nga nevojat/ rrethanat”, ka trende të ngjashme të rezultateve nga Bosnja dhe Hercegovina dhe Kroacia, të prezantuara më lartë. Ata të gjithë e bëjnë një punë të caktuar kohë pas kohe (varësisht nga rrethanat). Megjithatë, zakonisht është rasti që ata i ndërrojnë punët e shtëpisë ndërmjet partnerëve. Një pjesë e të anketuarve tonë janë më të prirur të marrin rolin e “djalit në natyrë”, me fjalë të tjera, në vozitje, në blerje të gjërave të ndryshme, në pastrimin e oborrit apo në ndreqjen e gjërave brenda në shtëpi. Megjithatë, gati të gjithë i vënë disa nga detyrat në kuptimin e “obligimeve të tij të zakonshme që duhet bërë”, sikurse – të gatujnë, të lajnë rrobat dhe enët,

dhe ta fshijnë shtëpinë. Ende, duket që ata e kanë pasur mundësinë të zgjedhin disa nga detyrat e tyre “të preferuara”.

Megjithatë, në disa aspekte, në edukim dhe kujdes shëndetësor, baballarët duket të jenë më të barabartë me nënat në ndarjen e punëve, në të qenurit i motivuar dhe i përfshirë. E njëjta vlen për përfshirjen e tyre në zhvillimin emocional dhe shoqëror të fëmijës – posaçërisht në zhvillimin e shkathtësive shoqërore, ku të gjithë të anketuarit i cilësuan si aspekte të rëndësishme që kërkojnë përfshirjen edhe të nënës e edhe të babait në mënyrë të barabartë. Një vërtetim tjetër i rëndësishëm është kur është fjala për zhvillimin e shkathtësive shoqërore – raportit me bashkëmoshatarët dhe autoritetet, të gjithë raportuan se zbatojnë tipare demokratike kur diskutojnë dhe marrin vendimet për ngjarje të rëndësishme, situata sfiduese – takime/panele në familje, etj. Është me rëndësi të vërrejmë që ndarja e barabartë e punëve në prindërim dëshmohej të jetë e lidhur me zhvillimin e raporteve dhe të barabarta partneriteti ndërmjet fëmijëve dhe prindërve – promovimin dhe respektimin e dinjitetit dhe të drejtave të fëmijës, e po ashtu edhe përgjegjësisë dhe pavarësisë. E tërë kjo ishte vlerësuar lartë nga shumica e të anketuarve të cilët raportuan që suksesi i tyre personal në prindërim do të ishte t'i ndihmojnë fëmijët të rriten në mënyrë të pavarur, të sigurt në vetvete, dhe anëtarë të përgjegjshëm në shoqëri.

Duke iu kthyer kuptimit të prindërimit dhe rolit të baballarëve në shoqërinë serbe, të anketuarit nuk i konsiderojnë ata si shumicë. Edhe pse ata e shohin shoqërinë serbe si progresive në kuptimin e pranimi të barazisë gjinore, ata i njohën ata stereotipe tradicionale të burrave dhe grave, posaçërisht në çështje familjare, janë ende të pranishëm dhe të promovuar nga një grup i zhurmshëm i njerëzve, që i perceptojnë vetvetën si shumicë. Megjithatë, ata nuk kanë lidhje me këtë grup, si dhe ata nuk konsiderojnë që mund të ndryshojnë pavarësisht përpjekjeve me

politika e programe, që do të mund të zhvillohej me atë qëllim. Është me rëndësi të përmendim që ata tregojnë nivel të konsiderueshëm të anonimitetit, madje edhe armiqësi për ato grupe në shoqëri. Qëndrimet e tyre negative ndaj atyre targeteve është me rëndësi të merren parasysh nëse edhe kur programet intervenuese krijohen (me fjalë të tjera, programe ku baballarë aktivë e të angazhuar shërbejnë si model, të cilët në mënyrë aktive promovojnë metoda të ndryshme për kujdesin atëror tek burrat démodé e tradicional).

Ata e konsiderojnë kornizën ligjore mjaft të drejtë në aspektin e njohjes dhe garantimit të barazisë gjinore, edhe pse ata nuk kanë ndonjë njohuri të veçantë për këtë çështje – ata informohen në masa të veçanta, me fjalë të tjera, në mundësitë që baballarët të marrin pushimin prindëror, apo të jenë të pranishëm në spital gjatë lindjes së fëmijës apo sëmundjes së fëmijës. Ata i kanë njohur problem të caktuara në zbatimin e atyre masave, që është problem në Serbi në përgjithësi, si dhe ata e njohën faktin që gratë janë edhe më të ndjeshme sesa burrat sa i përket të drejtave të punës, që kërkon zhvillim më të fuqishëm të masave mbrojtëse në këtë aspekt. Modelet kulturore dhe mungesa e motivimit për burrat për të kuptuar bukurinë e prindërimit të angazhuar është perceptuar si pengesat kryesore për prindër më të përgjegjshëm. Sipas tyre, nëse duam të bëjmë ndryshime në këtë aspekt, programet intervenuese duhet fokusuar tek fëmijët dhe të rinjtë, sa më herët që të jetë e mundur. Kjo do të mundësonte ndryshim në gjeneratë, sikurse që ishte rasti në jetën e të anketuarve, të cilët kanë raportuar që janë plotësisht/apo në mënyrë të konsiderueshme prindër krejtësisht tjerë për dallim nga prindërit e tyre, se tani ata e kuptojnë ndryshe dhe kanë pritshmëri tjera për partneren/in dhe raportet familjare.



Babai më i
MIRË

Rekomandimet kryesore

Rekomandimet kryesore janë bërë gjatë një sesioni të konferencës rajonale **“Atësia dhe Barazia Gjinore në Prindërim: Praktika, Politikat dhe Hulumtimi”** i mbajtur në nëntor të vitit 2015, organizuar nga CARE International Balkans. Gati 80 politikëbërës, hulumtues dhe përfaqësues të shoqërisë civile ishin pjesë e këtij procesi. Duke u bazuar në kontributin e pjesëmarrësve të Konferencës, rekomandime specifike për përmirësimin e politikave, hulumtimit dhe praktikave janë përkufizuar si në vijim:

Rekomandime të Përgjithshme

- Të themeloj një sistem gjithëpërfshirës dhe funksional që trajton burrat partner në promovimin e barazisë gjinore dhe i konsideron ata subjekte aktive në arritjen e barazisë gjinore në të gjitha nivelet.
- Të integroni çështjen e barazisë gjinore në prindërim dhe atësi aktive në politikat ekzistuese dhe zhvilloni politika të reja, dispozita ligjore, programe dhe shërbime në këtë fushë, në përputhshmëri me Konventën e Eliminimit të Diskriminimit ndaj Grave dhe Konventën e të Drejtave të Fëmijëve, posaçërisht me parimet e barazisë gjinore dhe dobitë më të mira për fëmijët, duke e përdorur ciklin jetësor dhe qasjen me bazë në moshë specifike.³⁹
- Të krijoni të sistem efektiv për mbledhjen e të dhënave dhe statistika gjithëpërfshirëse në aspektet gjinore të atësisë aktive dhe përfshirjes së barabartë të burrave në punë të shtëpisë/punë e papaguar.
- Të krijoni mekanizma operues për bashkëpunim ndërsektorial për qëllimin e promovimit, avokimit, monitorimit dhe

analizës efektive të masave dhe programeve ekzistuese.

Bashkëpunimi në mes të Shoqërisë Civile dhe Qeverisë

- Krijoni mirëkuptim në mes të sektorit të shoqërisë civile për nevojën e përfshirjes aktive të burrave në të gjitha veprimet në lidhje me barazinë gjinore (nga korniza e drejtësisë gjinore)
- Themeloni bashkëpunim afat-gjatë me të gjitha institucionet dhe organizatat relevante, dhe posaçërisht me institucionet e pavarura, institucionet arsimore dhe shëndetësore, qendrat për punë sociale dhe institucionet e tjera për përkrahje sociale, agjenci të punësimit dhe asociacione të punëtorëve, asociacione të prindërve, sindikalistë, organizata për fuqizim të grave, etj.
- Posaçërisht shënjestroni dhe themeloni bashkëpunim me organizatat që punojnë me grupe të marginalizuara (LGBTIQ, komunitete etnike, etj.)

Hulumtimi, Monitorimi dhe Avokimi Publik

- Mblidhni burimet ekzistuese që do të duhej të përdorëshin në promovimin e atësisë aktive dhe jo të dhunshme; organizatat, metodologjitë dhe mjetet në nivel kombëtar e rajonal.
- Zbatoni analizë gjithëpërfshirëse të politikave për të formuluar propozime të duhura politikash.
- Realizoni në mënyrë të vazhdueshme vlerësim të nevojave dhe hulumtim

gjithëpërfshirës për përfshirjen e burrave në përkujdesin ndaj fëmijëve dhe punës së papaguar.

- Zhvilloni mekanizma të qëndrueshme për pjesëmarrje për të monitoruar në mënyrë të vazhdueshme për zbatimin e politikave dhe masave e praktikave të veçanta, përfshirë institutin për kujdestari dhe aspekte të tjera që të të drejtave prindërore.
- Realizoni analizë për kost-benefitet e pabarazive gjinore dhe aspekteve të tyre të veçanta për të shërbyer si një nga mjetet më efektive të avokimit publik.
- Bëni evokim publik që synon të:
 1. institucionalizon çështjen e rolit aktiv dhe jo të dhunshëm të babait dhe ta integroj atë përmes politikave ekzistuese dhe kornizës ligjore.
 2. avancoj politikat ekzistuese dhe praktikat legjislativë dhe posaçërisht ato që kanë të bëjnë me pushim të paguar prindëror.
 3. Inkurajoj zbatimin e rregulloreve të barazisë

Zhvillimi i Kapaciteteve dhe Angazhimi i Burrave

- Zhvilloni programe dhe metodologji edukative dhe organizoni e ofroni trajnime për profesionistë/e nga institucionet dhe organizatat relevante që synojnë ngritjen e kapacitete të tyre për angazhim të duhur pro-aktiv në promovimin e rolit aktiv të burrave dhe pjesëmarrjes më të madhe të burrave në obligime të shtëpisë.
- Krijoni dhe zbatoni programe dhe shërbime offline dhe online për baballarët.
- Krijoni një kornizë për aktivizimin dhe

motivimin e vazhdueshëm të burrave për pjesëmarrje të plotë në përpjekjet për arritjen e barazisë gjinore, përfshirë rolin aktiv prindëror dhe përfshirjen në punë të shtëpisë përmes organizimit të grupeve mbështetëse bashkëmoshatare dhe zbatimin e qasjes me pjesëmarrje të lartë.

- Zbatoni aktivitete për ngritje të kapaciteteve me baballarët e interesuar në bashkëpunim me institucionet shëndetësore (posaçërisht gjinekologët), me shërbimet këshillëdhënëse për familjet, etj.
- Integrojeni konceptin e barazisë gjinore dhe përfshirjen aktive të burrave për arritjen e barazisë, si dhe aspektet e veçanta të atësisë aktive në plan-programe shkollore në të gjitha nivelet.

Promovimi dhe fushatat për Barazi Gjinore në Atësi

- Ofroni përkrahje të qëndrueshme për çështjen e rolit aktiv dhe jo të dhunshëm të babait dhe promovoni këtë çështje në mënyrë të vazhdueshme përmes medieve lokale, kombëtare dhe rajonale dhe përmes institucioneve dhe organizatave relevante, si dhe figura të njohura publike.
- Realizoni fushata rajonale dhe kombëtare me qytetarët e zakonshëm si dhe me personat e pushtetshëm të përkushtuar për kauza të rëndësishme.

39 - Duban, E. (2011). *Riparimi i Pabarazive: Burrat dhe Barazia Gjinore në rajonin e OSCE*. OSCE: Vienna

Rrugëtimi im drejt rolit të Babait të angazhuar

Prapavija ime familjare dhe ndikimi i saj në këtë udhëtim

Jam rritur në një familje të madhe në një vendbanim joformal rom dhe kam qenë njëri nga të gjashtë fëmijët në familje. Familja ime nuk ka qenë më ndryshe nga të tjerët në komunitetin tonë. Ne – tre vëllezërit dhe dy motrat e mija, u përballem me varfëri dhe pasiguri qysh në moshë të hershme. Prindërit e mi ishin të papunë dhe të paarsimuar. Babai im punonte për rrogë herë pas here, ndërsa nëna ime kërkonte mëshirë në fshatra afër komunitetit tonë duke provuar që në atë mënyrë të siguroj para për nevojat tona ditore. Unë nuk kam kujtime të mira nga ajo periudhë. Sikurse në familjet e tjera rome në komunitetin tonë, kujdesi për punët e përditshme ka qenë qartë e përkufizuar dhe e ndarë ndërmjet grave dhe burrave. Nënata janë kujdesur vetëm për fëmijët dhe shtëpinë, ndërsa baballarët ishin jashtë shtëpisë gati tërë ditën duke u munduar të sigurojnë mbajtjen e familjes. Nuk mund të flas shumë për raportin e prindërve të mijë, e cila, prapë po e them, nuk ishte ndryshe nga familjet e tjera. Ai raport përfshinte të gjitha nga pak; alkoolin, grindjet, etj. Besoj që shkollimi ka qenë sfida jonë më e madhe. Të dy prindërit ishin të paarsimuar, që do të thotë se ata nuk ishin në gjendje të na ndihmonin apo të na motivonin. Megjithatë, unë ia dola ta përfundoj shkollën e mesme dhe në fakt, kam shumë kujtime të mira që ndërlidhen me shkollimin tim dhe raportet në familje, posaçërisht në raport me nënën time. Ajo nuk dinte shkrim-lexim dhe unë doja ta mësoja atë të lexoj dhe të shkruaj. E mësoja gjithçka që unë mësoja në shkollë. Nuk mund të them që isha mësues i suksesshëm në atë kohë, por kohën që e kaluam bashkë ishte shumë e vlefshme për mua dhe për të. Më vonë kur u rrita, e krijova një raport të afërt edhe me babanë tim. Më pëlqente të flas me të dhe të këshillohem me të për vendimet e rëndësishme që më duhej t'i merrja.

Partneritetet – partnerja ime dhe unë

Želeo sam da uradim sve drugačije u svom životu od onoga što sam mogao da vidim oko sebe u svojoj zajednici i u svojoj porodici. U našoj kulturi, žene se udaju vrlo mlade, nezrele i nepripremljene za brak, za partnerski odnos i roditeljstvo. Hteo sam da nađem srodnu dušu i da izgradim zrelo partnerstvo zasnovano na ljubavi, uzajamnom poštovanju i ravnopravnosti. I uspeo sam! Moja supruga i ja smo zaposleni, i pored naših redovnih poslova aktivni smo u različitim nevladinim organizacijama koje razvijaju programe društvene inkluzije, potpuno drugačiji od naših roditelja. Moja supruga i ja smo razvili odnos koji je stabilan, uzajamno zavisian i u kome pružamo podršku jednom drugom.

Naša svakodnevna praksa je da razgovaramo o svemu – pitanjima koja se odnose na porodicu, dom, lične stvari i posao. S obzirom da i ona potiče iz romske zajednice, ona je moja srodna duša koja deli moju strast i misiju da se borimo za Rome kako bi postigli bolji kvalitet života, posebno za decu i žene. Uzajamno poštovanje, razumevanje i podrška, čak i onda kada drugačije doživljavamo ili vidimo stvari, su najvažniji simboli našeg odnosa.

Momenti për tu bërë baba – si na ka ndryshuar kjo përvojë: mua, partneren, jetën tonë

Për mua, atësia përfaqëson një detyrë dhe sfidë të rëndësishme personale. Qysh kur kam qenë fëmijë, kam ëndërruar të ndërtoj një familje tjetër nga ajo që unë e kam pasur, ku raportet në mes të partnerëve dhe atyre me fëmijë do të ishin plot dashuri, vëmendje dhe kujdes – krejt çka më ka munguar aq shumë si fëmijë. Sot, jam baba i gjashtë fëmijëve – tre fëmijë të mijë dhe tre fëmijë për të cilët kujdesemi si prindër birësues. Ne të dy njëjtë, unë dhe gruaja ime kemi dashur që jo vetëm t'i bëjmë fëmijët tonë biologjik, por po ashtu t'i ndihmojmë fëmijët tjerë në vendbanimet rome që të kenë mundësi për një jetë më të mirë. Më duhet të them që gruaja ime ka qenë më e vendosur të bëhet prind birësues sesa unë. Edhe pse punoja si asistent në një shkollë rome, dyshoja se mund t'ia dal. Ka qenë ndër vendimet më të rëndësishme që e kemi marrë në jetën tonë dhe sot guxoj të them që me sukses e kemi bërë një familje të madhe e të lumtur, e mbushur me përkrahje, kujdes e dashuri. Krenohem me të!

Ne e kemi krijuar një mënyrë krejtësisht tjetër nga familjet tjera rome, por ne e shohim atë mënyrë si mision për të bërë ndryshime përrreth nesh, ti motivojmë romët tjerë t'i përmbysin normat e dëmshme kulturore të sjelljes në komunitet. Kjo ka të bëjë me relacionet gjinore dhe rolet burrë e grua në ndarjen e punëve ditore. Në këtë aspekt, unë jam munduar që t'i ndaj në mënyrë të barabartë të gjitha përgjegjësitë me gruan time. Bëjmë plane ditore varësisht nga aktivitetet tona apo ato të fëmijëve. Kjo i referohet të gjitha temave dhe situatave kur flasim për obligime shtëpiake apo obligime që ndërlidhen me kujdesin ndaj fëmijëve (atë fizik, kujdesin shëndetësor, etj). Kështu që, ne të dy i bëjmë të gjitha llojet e punëve të shtëpisë. E dimë që jemi shembull për fëmijët tonë sepse është tejet e rëndësishme tu dëshmojmë fëmijëve që nuk ka dallime burrë-grua në këtë aspekt. Pasi që kemi gjashtë fëmijë – 3 vajza e 3 djem, ne i angazhojmë edhe ata me po të njëjtat detyra. Në këtë mënyrë, të gjithë i kanë obligimet e tyre që duhet t'i përmbushin. Të premtëve i kemi takimet familjare ku shkëmbejmë lajme, diskutojmë probleme, por edhe bëjmë marrëveshje e plane në lidhje me obligimet shtëpiake. Një familje e madhe në një shtëpi të madhe nuk mund të funksionoj ndryshe. Megjithatë, ne po ashtu mundohemi të respektojmë preferencat individuale ndaj detyrave të caktuara. Për shembull, mua më pëlqen shumë të përgatis ushqim dhe mund të them që jam shumë i zoti në këtë aspekt. Gruaja ime nuk është aq e interesuar në përgatitje të ushqimit, por fëmijët janë, e kjo më gëzon shumë.

Edhe obligime të tjera që ndërlidhen me kujdesin ndaj fëmijëve, i ndajmë në mënyrë të barabartë. Nuk më kujtohet ndonjë situatë kur ndonjëri nga fëmijët tonë ka qenë i sëmurë dhe ne nuk e kemi dërguar tek mjeku të dy së bashku si prindër. Të dy jemi kujdesur mirë

për ta kur kanë qenë të vegjël – iu kemi ndërruar pelenat, i kemi larë, i kemi vënë në shtrat, u kemi përgatitur ushqim. Nëse më duhet ta krahasoj rolin dhe qasjen time si baba me atë të bashkëshortes time ndaj nevojave të fëmijëve, do të thoja që ka një dallim në mënyrën se si ne e shfaqim dashurinë dhe kujdesin. Bashkëshortja ime është më emocionale, ndërsa unë jam aty të tregohem i fortë dhe përkrahës, tu jap vetëbesim dhe ndjesi sigurie për fëmijët dhe për bashkëshorten. Po ashtu, është me rëndësi të them se në disa mënyra, fëmijët më afrohen mua apo bashkëshortes varësisht nga çështjet apo problemet. Për shembull, vajzat janë ndërë më të lira të konsultohen me nënën e tyre për ndryshimet fizike me të cilat përballeshin gjatë adoleshencës, sesa me mua.

Shkollimi është një nga ato temat ku ne të dy jemi të përfshirë. Katër fëmijët tonë shkojnë në shkollë, dhe ne të dy mendojmë, diskutojmë dhe e planifikojmë shkollimin e tyre apo i zgjidhim problemet e tyre në shkollë. Në disa çështje, unë përfshihem më shumë në detyrat e tyre të shtëpisë, sepse jam më i shkolluar sesa gruaja ime. Megjithatë, të dy jemi të pranishëm në mbledhjet me prindër dhe të dy jemi pjesë e këshillit të prindërve si përfaqësues të klasës. Të dy mundohemi ta përcojmë porosinë se sa i rëndësishëm është shkollimi për të ardhmen e tyre.

Shoqërimi dhe zhvillimi i raporteve të shëndosha shoqërore me bashkëmoshatarët dhe autoritetet – është detyrë e rëndësishme dhe sfiduese për ne si familje. Ne jetojmë në një pjesë të qytetit të banuar kryesisht me familje kroate. Në fakt ne jemi e vetmja familje rome në lagje. Është sfiduese të sigurosh se fëmijët do të arrijnë të integrohen lehtë në çerdhe, në shkollë dhe me bashkëmoshatarët tjerë. Në njëfarë mënyrë, për disa institucione, ne ishim përvoja e tyre e parë si familje rome. Me fjalë të tjera, fëmija im ishte fëmija i parë rom në çerdhe. Kemi pasur sfida dhe jam krenar të them që kemi arritur t'i tejkalojmë ato në atë mënyrë që i ka ndihmuar institucioneve që të ngritin vetëdijen dhe kapacitetet e tyre për përfshirjen e fëmijëve të marginalizuar. Megjithatë, nuk është situatë e rehatshme dhe as e lehtë. Prapavija ime si aktivist, njohuri dhe përkrahja e akterëve të ndryshëm dhe OJQ-ve më ka ndihmuar shumë në ato situata. Por besoj që fuqia më e madhe më vjen nga fakti që e kam pasur bashkëshorten time në anën time në ato momente.

Edhe pse mendojmë se është me rëndësi të reagojmë dhe të luftojmë për të drejtat e të marginalizuarve, për përmirësimin e komuniteteve dhe institucioneve për t'i bërë më të vetëdijshme dhe më të qasshme, ne po ashtu mundohemi të ndërtojmë kapacitete për fëmijët tonë që ata të mund të përballen me problemet e tyre vet. Ne të dy mendojmë që është me rëndësi t'i përkrahim fëmijët tonë të krijojnë kufij të qartë dhe të jenë të vetëdijshëm për identitetin e tyre dhe të marrin përgjegjësi për veprimet e tyre. Ne kemi dërguar porosi dhe kemi ofruar përkrahje për ta luftuar diskriminimin, frikësimin, dhe agresionin fizik. Jam i lumtur të them që besoj që të gjithë fëmijët kanë raport të shëndoshë me shumicën e bashkëmoshatarëve të tyre (kanë shokë e shoqe të cilët i vizitojnë dhe shoqërohen), si dhe me autoritetet.



Babai më i MIRË

Vendi im në shoqëri si Baba i angazhuar

Përvoja si baba më ka dhënë një perspektivë të re si person. Është shumë më ndryshe kur ke përgjegjësi ndaj të tjerëve, kur duhet të japësh dashuri, kujdes dhe të ofrosh mundësi. Të jesh baba i angazhuar dhe përkrahës, në gjendje të jesh pranë fëmijëve gjatë gjithë kohës, nuk është detyrë e lehtë. Jo gjithçka ofrohet; kjo është diçka për të cilën duhet të mësojmë. Për komunitetin rom, kjo çështje ka rëndësi në veçanti sepse në shoqëri nuk ka përkrahje për burrat që të përfshihen në këtë mënyrë në jetën familjare. Normat dhe traditat janë më ndryshme. Ato më shumë kundërshtojnë se sa që përkrahin përfshirjen e burrave. Gruaja ime dhe unë e marrim këtë si mision jetësor për të promovuar, motivuar dhe përkrahur ato romë të cilët janë të gatshëm të "thyejnë guacat" dhe të zhvillojnë një jetë më cilësore për vet ata dhe fëmijët e tyre. Ne besojmë që ndryshimi do të jetë i mundur nëse arrijmë të krijojmë një grup të qëndrueshëm të atyre që përkrahin përpjekjet tona, duke ofruar shërbime, edukim dhe masa që do të na ndihmojnë për ta arritur këtë qëllim.



MenEngage
boys and men for gender equality

| **Baballarët në botë sot** |

MenCare

Pjesë të përshtatura nga: **Levtov R, van der Gaag N, Greene M, Kaufman M, dhe Barker G (2015).** Gjendja e Baballarëve të Botës: Përmbledhje: Publikim për Avokim i MenCare. Washington, DC: PROMUNDO, Rutgers, Save the Children, Sonke Gender Justice, dhe MenEngage Alliance

Gjendja e Baballarëve të Botës në një Vështrim: Përmbledhje dhe Rekomandime

Baballarët janë të rëndësishëm. Raporti baba-fëmijë në të gjitha komunitetet dhe në të gjitha fazat e jetës së fëmijës, ka ndikim të gjerë që vazhdon tërë jetën; qoftë ai raport pozitiv, negativ, apo edhe nëse nuk ekziston fare. Pjesëmarrja e burrave si baballarë dhe përkujdesës po ashtu ka rëndësi të jashtëzakonshme në jetën e grave. Kjo pjesëmarrje ndikon në mënyrë pozitive edhe në vet jetën e burrave.

Përafërsisht 80 përqind e burrave do të bëhen baballarë biologjik në një pikë të jetës së tyre, dhe pothuajse të gjithë burrat janë, në një mënyrë apo tjetrën, të lidhur me fëmijët – si të afërm, mësues, baballarë që kanë adoptuar apo birësuar fëmijë, apo thjesht si anëtarë të komunitetit. Qofshin baballarë biologjik, njerë, baballarë adoptues apo birësues, apo kujdestarë ligjor; qofshin vëllezër, xhaxhallarë, apo gjyshër; qofshin në një lidhje me një person të seksit të njëjtë apo atij të kundërt; dhe në qoftë se jetojnë me fëmijët e tyre apo jo; pjesëmarrja e burrave në kujdesin ditor të të tjerëve ka ndikim të përhershëm në jetën e fëmijëve, grave, dhe burrave, dhe ndikim të përhershëm në botën rreth tyre.

Ndryshimet masive në vendin e punës dhe në shtëpi po sjellin ndryshime në pjesëmarrjen e burrave si përkujdesës – që d.m.th. se gjendja e baballarëve të botës po ndryshon. Prapë se prapë, përfshirja e baballarëve si përkujdesës shpesh ka munguar në politikat publike, nga mbledhja sistematike e të dhënave dhe hulumtimi, dhe nga përpjekjet për të promovuar fuqizimin e grave.

Raporti i parë i Gjendjes së Baballarëve të Botës përmbledh të gjeturat kryesore të hulumtimit ndërkombëtar me shembujt për programe dhe politika që lidhen me pjesëmarrjen e burrave në përkujdesje; në të drejtat e shëndetit riprodhues dhe seksual; në shëndetin mëmësor, tëtë porsalindurve, dhe të fëmijëve; në dhunë dhe parandalimin e saj; dhe në zhvillimin e fëmijëve.

Gjendja e Baballarëve të Botës ka potencial t'i bëjë të dukshme disa nga ndryshimet më emocionuese që po ndodhin në jetën e burrave dhe grave rreth botës në syrin e publikut dhe në agjendën publike. Lëvizja drejt atësisë më të përfshirë dhe përkujdesje më të barabartë duhet përkrahur si pjesë e një agjende më të gjerë për të sfiduar strukturat dhe ideologjitë që na kufizojnë të gjithëve për tu zhvilluar si qenie të plota njerëzore në një shoqëri më të drejtë dhe më të barabartë.

Gjetjet kryesore

Baballarët e angazhuar ndihmojnë fëmijët të zhvillohen e të përparojnë.

Sa më shumë që burrat po përfshihen në përkujdesje, roli i tyre si baballarë po ndikon tek fëmijët në të njëjtën mënyrë sikurse përfshirja e nënave. Këtë po e dëshmon hulumtimi çdo herë e më shumë. Përfshirja e baballarëve është parë se ndërlidhet me një zhvillim më të madh kognitiv dhe arritje në shkollë, shëndet më të mirë mendor për djemtë e vajzat, dhe shkallë më të ulët të kriminalitetit tek djemtë. Studimet në shumë vende po ashtu po tregojnë që bashkëveprimi i baballarëve është i rëndësishëm për zhvillimin e empatisë dhe aftësive shoqërore tek djemtë dhe vajzat e tyre.

Baballarët e angazhuar ua mundësojnë grave dhe vajzave të arrijnë potencialin e tyre të plotë – tani dhe në brezat e ardhshme.

Në nivel global, gratë fitojnë përafërsisht 24 përqind më pak se burrat, kryesisht për shkak të barrës më të madhe që ato kanë në përkujdesje. Por, duke ndarë punët e shtëpisë dhe ato të përkujdesjes, burrat përkrahin pjesëmarrjen e grave në fuqinë punëtore dhe barazinë për gratë në përgjithësi. Përfshirja e baballarëve gjithashtu mban të emancipuar brezat e rinj; është dëshmuar se roli aktiv i baballarëve ka ndikuar që djemtë ta pranojnë barazinë gjinore dhe që vajzat të kenë sens të autonomisë dhe fuqizimit. Hulumtimi ka gjetur që ato vajza që kanë baballarë të cilët marrin përgjegjësi mbi punët e shtëpisë në mënyrë të barabartë me nënat, kanë prirje të aspirojnë profesione jo tradicionale gjinore dhe që paguhen më shumë. Të dhëna nga studime të realizuara në shumë vende, kanë treguar që burrat që kanë parë baballarët e tyre duke bërë punë të shtëpisë, kanë më shumë prirje të përfshihen vet në punë të shtëpisë dhe në përkujdesje si të rritur.

Baballarët e angazhuar janë burra më të shëndoshë dhe më të lumtur.

Burrat që përfshihen në mënyra të dobishme në jetën e fëmijëve të tyre raportojnë se ky raport është ndër burimet më të rëndësishme të mirëqenies dhe lumturisë. Studimet kanë treguar që baballarët që

raportojnë se kanë lidhje të afërta dhe jo të dhunshme me fëmijët e tyre, jetojnë më gjatë, kanë më pak probleme mendore dhe fizike, dhe kanë më pak prirje të abuzojnë me drogë, të jenë më produktiv në punë, dhe raportojnë se janë më të lumtur sesa baballarët që nuk se kanë raport të tillë me fëmijët e tyre.

Përfshirja e burrave në përkujdesje është në rritje e sipër në disa pjesë të botës, por askund nuk barazohet me atë të grave.

Gratë përbëjnë 40 përqind të fuqisë punëtore formale në nivel global, e në të njëjtën kohë vazhdojnë të kryejnë punë të shtëpisë dhe të përkujdesjes dy deri në dhjetë herë më shumë sesa burrat. Hulumtimi në përdorimin e kohës ka treguar që, përderisa gratë kanë marrë më shumë përgjegjësi jashtë shtëpisë, posaçërisht në fuqinë punëtore, pjesëmarrja e burrave në përkujdesje dhe punë të shtëpisë kryesisht nuk është mirëmbajtur. Një studim i trendeve për pjesëmarrjen e burrave ndërmjet vitit 1965 dhe 2003, në 20 vende, tregon për mesatare të rritur prej gjashtë orësh në javë në kontributin e burrave të punësuar e martuar në punë të shtëpisë dhe përkujdesje të fëmijëve. Prapë se prapë, kontributi i burrave nuk e ka tejkaluar 37 përqindshin e kontributit të grave në asnjërin prej këtyre vendeve.

Baballarët duan të kalojnë më shumë kohë me fëmijët e tyre.

Shumë baballarë rreth botës thonë që duan të jenë më të përfshirë në jetën e fëmijëve të tyre. Të dhëna nga Anketa Ndërkombëtare për Burrat dhe Barazinë Gjinore (ANBBGJ) tregojnë që shumë baballarë (duke filluar nga 34 përqind në Kroaci deri në 77 përqind në Kili) raportojnë që ata do të punonin më pak nëse kjo do të nënkuptonte që ata do të kalonin më shumë kohë me fëmijët e tyre. Në Shtetet e Bashkuara, një anketë ka gjetur që 46 përqind të baballarëve kanë thënë që nuk po kalojnë kohë të mjaftueshme me fëmijët e tyre, në krahasim me 23 përqind të nënave.

Pjesëmarrja dhe përkrahja e burrave nevojitet urgjentisht për të siguruar që të gjithë fëmijët janë fëmijë të dëshiruar.

Më shumë se 220 milionë grave u mungon qasja në mjete të sigurta dhe të efektshme kontraceptive, apo nuk i përdorin ato fare. Kjo ua pamundëson atyre të shtyjnë shtatzëninë apo të kenë hapësirë në mes të shtatzënive duke i ekspozuar kështu ndaj rreziqeve më të mëdha drejt vdekjeve të nënave apo të foshnjave të tyre. Në nivel global, rreth 85 milionë shtatzëni kanë qenë të paplanifikuara në 2012, që përfaqëson 40 përqind të të gjitha shtatzënive. Përdorimi i mjeteve kontraceptive për gratë përfaqëson përafërsisht tre të katërtat të përdorimit total të mjeteve kontraceptive në mbarë botën, proporcion ky që ka ndryshuar pak gjatë 20 viteve. Më shumë duhet të bëhet për t'i angazhuar burrat në përdorim të mjeteve kontraceptive dhe vendimmarrje në mënyra që përkrahin zgjedhjet riprodhuese për gratë, dhe për të siguruar që të gjitha shtatzënitë janë shtatzëni të dëshiruara. Pavarësisht se a është fjala për barazi gjinore, studimet rreth botës kanë treguar që baballarët kanë më shumë prirje të përfshihen në jetën e fëmijëve të cilët i kanë planifikuar t'i kenë, me dobi afatgjatë për ata fëmijë.

Angazhimi i burrave – në ato mënyra që gratë duan – qysh në fillim të vizitave të para-lindjes, në lindje, dhe menjëherë pas lindjes së fëmijës mund të sjellë dobi afatgjatë.

Përfshirja e baballarëve para, gjatë, dhe pas lindjes së fëmijës është treguar se ka ndikim pozitiv në sjellje të shëndetit amënor, në përdorimin e shërbimeve amënore dhe të porsalindurve nga gratë, dhe përkrahja afatgjatë e baballarëve dhe përfshirja në jetën e fëmijëve të tyre. Në vende me të ardhura të ulëta dhe mesatare, prania e burrave në vizitat e para-lindjes dallon shumë – nga vetëm 18 përqind në Burundie deri në 96 përqind në Maldive. Një analizë e freskët hulumtuese nga vendet me të ardhura të ulëta dhe mesatare, ka gjetur që përfshirja e burrave është asociuar në mënyrë të konsiderueshme me pjesëmarrje të shkathtësive të përmirësuar rreth lindjes, përdorim të kujdesit të pas-lindjes, dhe më pak gra që kanë vdekur gjatë lindjes. Në vende me të ardhura të larta, prania e baballarëve ka treguar të jetë e dobishme në inkurajimin dhe përkrahjen e nënave për të dhënë gjë. Përkrahja e baballarëve po

ashtu ka ndikuar në vendimet e grave për t'i vaksinuar fëmijët e tyre dhe të kërkojnë kujdes për sëmundje të fëmijërisë.

Promovimi i përfshirjes së baballarëve duhet të përfshijë përpjekjet për ta ndërprerë ciklin e dhunës.

Përafërsisht, një në tre gra përjetojnë dhunë nga një partner mashkull në jetën e saj. Tre të katërtat e fëmijëve ndërmjet dy dhe katërmëdhjetë vjet në vende me të ardhura të ulëta dhe mesatare kanë përjetuar ndonjë formë të disiplinës së dhunshme në shtëpi. Këto forma të dhunës shpesh bashkë-ndodhin. Studimet në vende me të ardhura të larta sugjerojnë që kudo ndërmjet 45 dhe 70 përqind të fëmijëve nënat e të cilëve po përjetojnë dhunë, përjetojnë abuzim fizik. Hulumtimi konfirmon që disa forma të dhunës – posaçërisht dhuna e burrave ndaj partnereve femra – shpesh transmetohen nga njëri brez tek tjetri. Të dhëna nga tetë vende kanë gjetur që burrat, të cilët, si fëmijë, kanë qenë dëshmitarë kur nënat e tyre janë rrahur nga një partner mashkull, kanë qenë përafërsisht dy herë e gjysmë më shumë të prirur të përdorin dhunë ndaj një partnere femër si të rritur. Në të njëjtën kohë, hulumtimi tregon që ndarja e barabartë e përkujdesjes kontribuon në shkallë më të ulët të dhunës ndaj fëmijëve: një studim përfaqësues në nivel kombëtar në Norvegji ka gjetur që shkalla e dhunës ndaj fëmijëve – nga nënat dhe baballarët – ka qenë më e ulët në ato shtëpi ku burrat e gratë kanë qenë përkujdesës të barabartë.

Fëmijët, gratë, dhe burrat përfitojnë kur baballarët marrin pushimin e lindjes.

Përderisa lejet e lindjes ofrohen gati në të gjitha vendet, vetëm 92 përqind e vendeve ofrojnë pushim që mund të shfrytëzohet nga baballarët e rinj; në gjysmën e këtyre vendeve, pushimi zgjat më pak se tre javë. Politikat e hartuara mirë të pushimit, kur kombinohen me kujdes të fëmijëve që është falas apo i përballueshëm, tregon se ka potencial më të fortë për të ndërruar barrën e kujdesit. Pushimi për baballarët është hap qenësor drejt njohjes së rëndësisë që ka ndarja e përkujdesjes ndaj fëmijëve, dhe është mjet i rëndësishëm për të promovuar mirëqenien e fëmijëve dhe barazinë gjinore në shtëpi, në

punë, dhe në shoqëri si tërësi. Në Mbretërinë e Bashkuar, baballarët që kanë marrë pushim pas lindjes, kanë qenë 19 përqind më të prirur ta ushqejnë fëmijën dhe të zgjohen me foshnjën natën tetë deri në 12 muaj më vonë, në krahasim me baballarët që nuk e kanë shfrytëzuar pushimin. Për më shumë, pushimi për baballarët duket se rezulton me shëndet të përmirësuar mëmësor – përfshirë shëndetin mendor – dhe me më pak shqetësim prindëror.

Përfshija më e madhe e burrave në përkujdesje sjellë dobi ekonomike.

Vlerësohet se po të merrnin gratë pjesë në tregun e punës në të njëjtën shkallë sikurse burrat, në Shtetet e Bashkuara Bruto Produkti Vendorë (BPV) do të rritej për 5 përqind, në Japoni për 9 përqind, në Emiratet e Bashkuara Arabe për 12 përqind, dhe në Egjipt për 34 përqind. Praktika po e dëshmon që pushimi prindëror me pagesës-jellë dobi për bizneset; përmirëson mbajtjen e punonjësve në punë dhe zvogëlon shkallën e zëvendësimit të fuqisë punëtore, ngrit moralin dhe produktivitetin, dhe ul mos-vajtjen dhe kostot e trajnimit. Në nivel të familjes, pushimi i atësisë përkrah pjesëmarrjen e grave në tregun e punës dhe mund të përmirësoj të ardhurat dhe karrierën. Një studim nga Suedi ka treguar që për çdo muaj që baballarët marrin pushim të atësisë, të ardhurat e nënës janë rritur për 6.7 përqind, siç është matur katër vite më parë, që nënkupton më shumë sesa të kishte marrë vet atë pushim.

Rekomandimet për të ndryshuar gjendjen e baballarëve të botës

Për të arritur barazi të plotë gjinore dhe mirëqenie maksimale për fëmijët, duhet të lëvizim përtej përkufizimeve të rrepta dhe kufizuese të atësisë dhe amësisë, dhe drejt asaj që i bën fëmijët të përparojnë. Kjo nuk ka të bëjë vetëm me inkurajimin e burrave që t'i kultivojnë parimet e përkujdesjes. Kjo është çështje e drejtësisë shoqërore dhe ekonomike. Ndryshime nevojiten në politika, në sisteme dhe institucione, tek ofruesit e shërbimeve, në përpjekjet për mbledhjen e të dhënave dhe në analiza. Ky raport ofron rekomandime specifike për ndryshime në secilin prej këtyre niveleve. Këto rekomandime mund të përmbliken si në vijim:

1. **Hartoni plane veprimi në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar për të promovuar atësi të përfshirë dhe jo të dhunshme, dhe ndarje të barabartë të burrave dhe djemve në përkujdesjes pa pagesë.** Plane veprimi për atësinë dhe përkujdesjen duhen zgjeruar në shumë sektorë, përfshirë sektorin e barazisë gjinore, të drejtave të fëmijëve, shëndetësisë, arsimit, zhvillimit ekonomik, parandalimit të dhunës dhe reagimet ndaj dhunës, si dhe në sektorin e të drejtave të punës. Veprimet duhet të përshtaten me indikatorë dhe buxhet të qartë për ta matur progresin dhe për t'i bërë

të dukshme nevojat e djemve dhe burrave për ndarje më të drejtë të përgjegjësisë në përkujdesje.

2. **2 Implementim i këtyre planeve veprimi dhe politika në sistemet dhe institucionet publike për të mundësuar dhe promovuar pjesëmarrjen e barabartë në prindërim dhe përkujdesje.**

Kjo përfshin transformimin e politikave, protokolleve, dhe kurrikulave, si dhe të strukturave dhe hapësirave, në sektorë të ndryshme sikurse në shëndetësi, arsim, punësim, dhe shërbime sociale. Kjo është e nevojshme për të siguruar që këto institucione janë të afta t'i sfidojnë norma të padrejta rreth burrave në përkujdesje, sesa t'i përforcojnë ato.

3. **Themeloni dhe zbatoni politika të barabarta, me pagesë dhe jo të transferrueshme të lejes prindërore të lindjes, edhe në sektorët publik dhe ata privat, si dhe politika të tjera që lejon pjesëmarrjen e barabartë të grave në fuqinë punëtore dhe pjesëmarrjen e barabartë të burrave në përkujdesje pa pagesë.** Në mjedise ku një masë e gjerë i popullatës nuk është e punësuar formalisht, politika dhe strategji të ndryshme nevojiten për të promovuar burrat në përkujdesje; transferimi

me kusht i të hollave dhe sisteme të sigurimit shoqëror janë disa nga to.

4. **Mblidhni dhe analizoni të dhënat rreth përfshirjes së burrave dhe përkujdesësve dhe gjeneroni dëshmi të reja nga programet dhe politikat** që punojnë për të transformuar dhënien e kujdesit pa pagesë, për të parandaluar dhunën kundër grave dhe fëmijëve, dhe për të përmirësuar rezultatet shëndetësore dhe zhvillimore për gratë, fëmijët, dhe burrat.
5. **Arrini transformim radikal në ndarjen e përgjegjësive në përkujdesje për programe me djem dhe burra, si dhe me gra e vajza që sfidojnë normat shoqërore dhe promovojnë përfshirjen e tyre pozitive në jetën e fëmijëve.** Puna për sfidimin e normave të dëmshme gjinore duhet të filloj herët dhe të vazhdoj përgjatë jetës. Djemtë dhe vajzat duhet të jenë të përgatitur qysh në moshë të hershme për t'u bërë përkujdesës në të ardhmen. Programe brenda institucioneve dhe strukturave ekzistuese duhet vënë, sikurse në shkolla, në iniciativa për zhvillim të hershëm të fëmijëve, shërbime shëndetësore dhe edukim, programe për prindërim, dhe parandalim të dhunës dhe përpjekjeve për të reaguar kundër saj, për të siguruar zbatimin e tyre në shkallë.

6. **Njihni diversitetin e përkujdesjes së burrave në përkujdesje dhe përkrahni atë në të gjitha format.** Programe dhe politika duhen hartuar në mënyra që njohin dhe u përgjigjen nevojave të konfigurimeve të ndryshme familjare, përfshirë prindërit vetushqyes, prindërit adoptues, baballarët jo-rezident, baballarët homoseksual, baballarët adoleshentë, dhe familjet e gjëra.

Gjatë zbatimit të të gjitha këtyre rekomandimeve, pjesëmarrja e fëmijëve është e nevojshme për të përkufizuar dhe realizuar një vizion të ri të atësisë dhe përkujdesjes.

Angazhimi i burrave në përkujdesje është për t'i u ndihmuar burrave të kenë lidhje të thella dhe domethënëse me të tjerët, e kjo përbën rrënjën e mirëqenies dhe lumturisë. Por edhe përtej kësaj, angazhimi i burrave në përkujdesje u mundëson burrave, grave, dhe fëmijëve të përmbushin potencialin e tyre të plotë. Ky angazhim ka të bëjë edhe me arritjen e barazisë së plotë të grave dhe vajzave. *Gjendja e Baballarëve të Botës 2015* thotë se është koha të ndërrojmë perceptimin dhe realitetin për rolin që burrat kanë në përkujdesje, dhe të sjellin masat shoqërore dhe mbështetjen e nevojshme ekonomike, sociale dhe politike për ta bërë të mundur këtë transformim.



MenEngage
boys and men for gender equality

| **Baballarët në botë sot** |



MenCare

Pjesë të përshtatura nga: **Levtov R, van der Gaag N, Greene M, Kaufman M, dhe Barker G (2015)**. Gjendja e Baballarëve të Botës: Përmbledhje: Publikim për Avokim i MenCare. Washington, DC: PROMUNDO, Rutgers, Save the Children, Sonke Gender Justice, dhe MenEngage Alliance

CARE International Balkan:

Hasana Kaimije 11
71000 Sarajevo
Bosnia and Herzegovina
Phone: +387 33 536 790

Petra Lekovica 59
11000 Belgrade, Serbia
Phone: +381 11 3558 802
Email: mstarcevic@care.rs

Aleja Svetog Save 7a #17
78000 Banja Luka
Bosnia and Herzegovina
Phone: +387 51 258 200
Email: spetkovic@carewb.org,
jcrowover@carewb.org

Gazmend Zajmi # 21
10 000 Prishtinë, Kosovë
tel: +381 (0) 38 224 779; 222 435
Email: Besnik.Leka@co.care.org

www.youngmeninitiative.net

ORGANIZATAT IMPLEMENTUESE TE YMI:

